



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**FTESË PËR KUALIFIKIM PËR
PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE TË ERËS
NË TOKË QË DO TË PËRFITOJNË MASA
MBËSHTETËSE, ME VENDODHJE TË
PERCAKTUAR NGA ZHVILLUESIT**

Tabela e përmbajtjes

1		
Tabela e përmbajtjes.....	0	
PËRKUFIZIME.....	4	
Përfaqësues i Autorizuar.....	4	
Ditë Pune	4	
Çmimi Tavan.....	4	
Bashkimi i Shoqërive.....	4	
Formulari i Njoftimit	7	
Person 7		
Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike apo PPA.....	7	
Projekti 7		
Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit apo PDA.....	7	
Dokumentet e Projektit.....	7	
Vendndodhja e Propozuar	7	
Ofertuesi Potencial	8	
Aplikim për Kualifikim	8	
Afati i Dorëzimit i Aplikimit për Kualifikim	8	
Kërkesë për Propozim apo KPP	8	
Kërkesë për Kualifikim apo KPK.....	8	
Dokumentet KPP	8	
Dokumentet KPK	8	
Ofertuesi i Përzgjedhur	8	
Vendndodhja.....	8	
Komisioni i Posaçëm.....	8	
NJOFTIMI I KËRKESËS PËR KUALIFIKIM	10	
1.5.1 Struktura kontraktore përpara ndodhjes së një Rasti Konvertimi	12	
1.5.2 Struktura kontraktore pas ndodhjes së një Rasti Konvertimi.....	14	
1.6 Vendndodhja	15	
1.7 Lidhja me Rrjetin e Transmetimit.....	15	
1.8 Afati Kohor për Kryerjen e Punimeve:	15	
1.9 Informacioni Ligjor, Ekonomik, Financiar dhe Teknik (Dokumentet e Kualifikimit)	15	
1.10 Procedura Konkurruese	16	
1.11 Afati i Dorëzimit të Aplikimeve për Kualifikim.....	16	
1.12 Hapja e Aplikimeve për Kualifikim.....	16	
1.13 Gjuha.....	16	
1.14 Data e Shpalljes së Njoftimit të Procedurës së Kualifikimit.....	16	
1.15 Data e Konferencës për Ofertuesit Potencialë.....	17	
1.16 Njoftimet / korrespondenca	17	
2 HYRJE	18	
3 PROCEDURA KONKURUESE	19	
3.1 Sqarimi i pyetjeve dhe Ndryshimet.....	19	
3.2 Kalendari i Parashikuar.....	20	
3.3 Konferenca për Ofertuesit Potencialë	20	
3.4 Kërkimet dhe studimet e Ofertuesve Potencialë (<i>DueDiligence</i>)	20	
3.5 Konfidencialiteti i Aplikimit për Kualifikim	20	
3.6 Konfidencialiteti i informacionit të Autoritetit Kontraktues.....	21	
3.7 Përdorimi i dokumenteve të Aplikimit për Kualifikim	21	

3.8	Përhapja e informacionit	22
3.9	Të drejta shtesë të Autoritetit Kontraktues.....	22
3.10	Informacioni i rremë	23
3.11	Konflikti i interesit	23
3.13	Kostot	23
3.14	Konsorciumi ose Bashkimi i Shoqërive	24
4	PËRGATITJA E APLIKIMEVE PËR KUALIFIKIM	25
4.1	Përmbajtja e Aplikimit për Kualifikim	25
4.2	Gjuha e Aplikimit për Kualifikim	25
4.3	Referenca të qarta.....	25
5	DORËZIMI I APLIKIMI PËR KUALIFIKIMVE.....	26
5.1	Afati i Dorëzimit i Aplikimit për Kualifikim	26
5.2	Forma e Dorëzimit	26
6	TËRHEQJA E APLIKIMEVE PËR KUALIFIKIM.....	28
6.1	Kërkesat për informacion shtesë	28
6.2	Tërheqja e Aplikimeve për Kualifikim	28
6.3	Gabimet jo-thelbësore, të paqëllimshme, parregullsi apo mungesë informacioni në Aplikim për Kualifikim	28
7	RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E APLIKIMEVE PËR KUALIFIKIM	29
8	KUALIFIKIMI I OFERTUESVE POTENCIALË DHE APLIKIMET PËR KUALIFIKIM.....	32
8.1	Kualifikimi i Ofertuesve Potencialë.....	32
8.2	Dokumentet e Kualifikimit	32
8.3	Shqyrtimi i Dokumenteve të Kualifikimit.....	32
	Kriteret e Kualifikimit të përcaktuara në Shtojcën 4 dhe 4/1, do të vlerësohen me “kalon” / “nuk kalon” për çdo kriter.....	32
9	KUFIZIMET	34
9.2	E drejta për ta deklaruar Procedurën e Kualifikimit “të pasuksesshme”	34
9.3	E drejta për ta deklaruar Aplikimin për Kualifikim të pavlefshëm.....	34
10.	INFORMACIONE TË MËTEJSHME PËR FAZËN (E 2-TE) E KPP.....	35
10.1	Kërkesat në fazën e KPP.....	35
	LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL	41
	SHTOJCA 2.....	42
	FORMULARI I DEKLARIMIT TË APLIKIMIT PËR KUALIFIKIM	42
	SHTOJCA 3.....	43
	DEKLARATË MBI KONFLIKTIN E INTERESIT	43
	SHTOJCA 4.....	45
	KRITERET E KUALIFIKIMIT	45
	SHTOJCA 4/1	51
	KRITERE SPECIFIKE KUALIFIKIMI	51
	FORMULARI A1	54
	FORMULARI A2	56
	SHTOJCA 5.....	58
	DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE PENALE	58
	SHTOJCA 6.....	59
	VETËDEKLARIM PËR OFERTUESIT POTENCIAL TE HUAJ	59
	SHTOJCA 7.....	61
	SPECIFIKIMET TEKNIKE MINIMALE	61

SHTOJCA 8.....	69
FORMULARI I NJOFTIMIT TË OFERTUESIT POTENCIAL TË SKUALIFIKUAR	69
SHTOJCA 9.....	70
FORMULARI I NJOFTIMIT TË OFERTUESIT TË PARA-KUALIFIKUAR.....	70
SHTOJCA 10.....	71
FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT KONTRAKTUES.....	71
SHTOJCA 11.....	74
FORMA E PROKURËS SË POSAÇME	74
SHTOJCA 12.....	75
INFORMACION MBI SHOQËRINË E OFERTUESVE POTENCIAL	75
SHTOJCA 13.....	76
KALENDARI I PARASHIKUAR	76
SHTOJCA 14 (Faza e KPK).....	77
SHTOJCA 15.....	84
WIND SITING STUDY	84

FTESË PËR KUALIFIKIM

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ("**MIE**") vë në dispozicion këto dokumente të kërkesës për kualifikim ("**Dokumentet e KPK**") dhe fton të Ofertuesit Potencialë (sipas përkufizimit më poshtë) të përgatitin dhe dorëzojnë një Aplikim për Kualifikim (sipas përkufizimit më poshtë) si pjesë e Procedurës së Kualifikimit (sipas përkufizimit më poshtë) në lidhje me Projektet (sipas përkufizimit më poshtë). Kjo Kërkesë për Kualifikim është faza e parë e procedurës me dy faza, që do të pasohet nga një fazë e mëvonshme e dokumentacionit të Kërkesës për Propozim (KPP).

NJOFTIM PËR PËRJASHTIM NGA PËRGJEGJËSIA

As MIE dhe as ndonjë prej konsulentëve apo këshilltarëve të saj:

- (a) nuk jep ndonjë deklaram ose garanci (të shprehur apo të nënkuptuar) që informacioni i dhënë në këto dokumente apo në çdo dokument tjetër që i vihet në dispozicion një Ofertuesi Potencial (në çdo kohë) në lidhje me Procedurën e Kualifikimit, është i saktë apo i plotë;
- (b) nuk mban asnjë përgjegjësi për këto Dokumente të KPK, për Projektet ose për çdo komunikim të shkruar apo verbal që i transmetohet Ofertuesit në lidhje me Procedurën e Kualifikimit ose me kualifikimin e një Ofertuesi Potencial, ose
- (c) nuk është përgjegjës për të rimbursuar apo për t'i kompensuar një Ofertuesi Potencial kostot ose shpenzimet e kryera prej tij për vlerësimin apo për veprimin sipas këtyre Dokumenteve të KPK apo në lidhje me Procedurën e Kualifikimit, Procedurën Konkurruese, me Projektet apo çdo gjë tjetër.

Këto Dokumente të KPK përbëjnë një ftesë për të paraqitur një Aplikim për Kualifikim. Ato nuk përbëjnë kërkesë për investim apo për pjesëmarrje në Projektet.

PËRKUFIZIME

Përfaqësues i Autorizuar

është përfaqësuesi i Ofertuesit Potencial (ose në rastin e një Bashkimi të Shoqërive, përfaqësuesi i autorizuar i Bashkimit të Shoqërive) i autorizuar për të nënshkruar Aplikimin për Kualifikim në bazë të prokurës në formën e Shtojcës 11 (*Prokura*).

Legjislacioni i Zbatueshëm

është, në lidhje me çdo palë, çdo akt detyrues ndërkombëtar, çdo dispozitë kushtetuese, ligj, statut, rregull, rregullore, urdhëresë, traktat, urdhër, dekret, vendim, certifikatë, akt, urdhëresë, regjistrim, licencë, franchisë, leje, autorizim, udhëzim, Miratim Qeveritar, pëlqim ose kërkesë të një Autoriteti Kompetent që ka juridiksion mbi Palën ose pronën e saj, të zbatueshëm sipas ligjit apo statutit, duke përfshirë interpretimin dhe administrimin e saj nga Autoriteti Kompetent.

Ditë Pune

çdo ditë tjetër përveç të shtunës, të dielës ose çdo ditë tjetër zyrtare festash sipas Legjislacionit të Zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Çmimi Tavan

ka kuptimin që i jepet në paragrafin 10.1 të këtyre Dokumenteve të KPK.

Autoriteti Kompetent

është çdo autoritet, ministri, inspektorat, departament, gjykatë, gjykatë arbitrazhi, agjenci administrative ose komision ose ndonjë organ tjetër qeveritar, bashkiak, administrativ ose rregullator ndërkombëtar, kombëtar, vendor ose tjetër (në secilin rast deri në masën ku secili nga të mësipërmët ka juridiksion mbi këto dokumente të KPK ose në Procedurën Konkurruese);

Bashkimi i Shoqërive

ka kuptimin që i jepet në paragrafin 3.14 të këtyre Dokumenteve të KPK.

Personi i Kontaktit

është personi i identifikuar në paragrafin 1.1 të këtyre Dokumenteve të KPK.

Kontratë për Diferencë (CfD)

është kontrata e likuiduar financiarisht për diferencat që do të nënshkruhet nga një Zhvillues dhe Operatori i Energjisë së Rinovueshme (OER) si palë në CfD (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit) për pagimin e shpërblimit të ndryshueshëm simetrik në raport me çmimin referencë të tregut në

lidhje me energjinë e prodhuar nga Impianti i përzgjedhur.

Autoriteti Kontraktues apo MIE

është Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë së Republikës së Shqipërisë.

Kontroll

është mundësia për të ushtruar kontroll dominues në një shoqëri, person fizik apo juridik, nëpërmjet të drejtave të votës apo ortakut, kontratë apo mënyrë tjetër, veçmas apo bashkarisht, sipas fakteve dhe ligjit.

Konvertim

është konvertimi i Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike nga një marrëveshje për blerjen e energjisë elektrik me likuidim fizik në një marrëveshje për blerjen e energjisë elektrike të likuiduar financiarisht në përputhje me kushtet e konvertimit të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike.

Rasti i Konvertimit

është:

- përcaktimi nga Autoriteti Kompetent se energjia elektrike e prodhuar nga Impianti do të jetë e disponueshme për blerje në tregun e organizuar të energjisë elektrike në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike të krijuar sipas Legjislacionit të Zbatueshëm;
- krijimi i bursës së energjisë elektrike dhe ofrimi i çmimeve ekuilibër për periudhën përkatëse të shlyerjes nga operatori i bursës së energjisë elektrike të cilët janë të shpeshta dhe likuide sa duhet për të shërbyer si çmime reference të ndryshueshme ndaj Çmimit të Energjisë Elektrike (si një çmim fiks *eng. Strike price*) për të mundësuar shlyerjen financiare bazuar në diferencën ndërmjet çmimit të ndryshueshëm dhe çmimit fiks; dhe
- likuiditeti i mjaftueshëm i tregut të organizuar të energjisë elektrike përcaktohet nga një Autoritet Kompetent bazuar në një vlerësim të thelluar të tregut me shumicë të energjisë elektrike, vlerësim i cili bëhet jo më herët se dymbëdhjetë (12) muaj kalendarikë pas krijimit të tregut të organizuar të energjisë elektrike dhe bazohet në një numër treguesish kryesor, që do të përcaktohen dhe publikohen më vonë.

Zhvillues

është çdo Ofertues i Përzgjedhur në fazën e KPP, që do të lidhë Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit me Autoritetin Kontraktues.

Impianti	është impianti për prodhimin e energjisë elektrike dhe infrastruktura e tij, përfshirë turbinat e erës, me vendndodhje që do të përcaktohet nga një Ofertues i Përzgjedhur në Republikën e Shqipërisë dhe një linjë e lidhjeje që do të ndërtohet nga një Ofertues i Përzgjedhur.
Aplikimi për Kualifikim Financiar	është çmimi në EUR për MW, për energjinë e prodhuar, që do të dorëzohet nga një Ofertues i Para-Kualifikuar, si pjesë e Aplikimit për Kualifikim së tij financiare në fazën e KPP.
Praktika e Mirë e Industrisë	është shkalla e aftësive dhe kujdesit që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një kontraktues me përvojë në të njëjtin lloj sipërmarrjeje (projektim, inxhinieri, instalim, ndërtim, kompletim, kolaudim, testim, operim dhe mirëmbajtje) në lidhje me projekte të një madhësie, fushëveprimi, shkalle, natyre dhe kompleksiteti të ngjashëm me Impiantin.
Miratim Qeveritar	shtë çdo miratim, pëlqim, ekskluzivitete, leje, certifikatë, vendim, koncesion, licencë, ose autorizim të lëshuar nga ose në emër të Autoritetit Kompetent përkatës;
Anëtar Kryesues	ka kuptimin që i jepet në paragrafin 3.14.2 të këtyre Dokumenteve të KPK.
Vlerësimi i Gatishmërisë së Tregut	është: - krijimi i bursës së energjisë elektrike dhe ofrimi i çmimeve ekuilibër për periudhën përkatëse të shlyerjes nga operatori i bursës së energjisë elektrike të cilat janë të shpeshta dhe likuide sa duhet për të shërbyer si çmime të ndryshueshme reference ndaj Çmimit të Energjisë Elektrike (si një çmim fiks <i>eng. Strike price</i>) për të mundësuar shlyerjen financiare bazuar në diferencën ndërmjet çmimit të ndryshueshëm dhe çmimit fiks; - gatishmëria e tregut të organizuar të energjisë elektrike përcaktohet nga një Autoritet Kompetent bazuar në një vlerësim të thelluar të tregut të ditës së ditës në avancë, vlerësim i cili bëhet jo më herët se [dymbëdhjetë (12)] muaj kalendarikë pas krijimit të tregut të organizuar të energjisë elektrike dhe bazohet në një numër treguesish kryesor, që do të përcaktohen dhe publikohen më vonë. - krijimi i një Operatori të Energjisë së Rinovueshme (OER) që do të jetë si palë në CfD në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, si dhe vendosja e detyrimit për rregullimin e çështjeve të organizimit të

shoqërisë dhe çështjet financiare të OER, veçanërisht krijimin e një mekanizmi funksional për përcaktimin dhe shlyerjen e detyrimit për energjinë e rinovueshme në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, të jetë efektiv të paktën prej 3 muajsh para datës së publikimit të KPP.

Ofertuesi i Skualifikuar

është një Ofertues Potencial, që nuk ka përmbushur Kriteret e Kualifikimit, siç përcaktohet në paragrafin 8.3.5 të këtyre Dokumenteve të KPK.

Formulari i Njoftimit

është njoftimi në formën e Shtojcës 9 (*Formulari i Njoftimit të Ofertuesit të Para-Kualifikuar*).

Person

është një person fizik apo një Shoqëri.

Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike apo PPA

është Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike që do të lidhet ndërmjet Zhvilluesit dhe Blerësit kur nuk është kryer një Vlerësim i Gatishmërisë së Tregut para datës së publikimit të KPP-së (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit) për shitjen e energjisë elektrike së prodhuar nga Impianti i përzgjedhur, dhe drafti i së cilës do të publikohet në Proçesin e Konsultimit dhe si pjesë e paketës KPP.

Ofertuesi/t i/e Para-Kualifikuar

janë Ofertuesit Potencialë që plotësojnë Kriteret e Kualifikimit dhe që janë ftuar për të marrë pjesë në fazën e KPP.

Projekti

është projektimi, financimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e secilit Impiantit ere në tokë me kapacitet të instaluar nga 10 MW në 75 MW (përfshirë), të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të përcaktuar nga Ofertuesi i Përzgjedhur në Republikën e Shqipërisë.

Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit apo PDA

është Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit që do të lidhet ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Ofertuesit të Përzgjedhur, drafti i së cilës do të publikohet në Proçesin e Konsultimit dhe si pjesë e paketës KPP.

Dokumentet e Projektit

janë Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit dhe Kontrata për Diferencë apo Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike sipas rastit, në varësi të Vlerësimit të Gatishmërisë së Tregut.

Vendndodhja e Propozuar

është vendndodhja e identifikuar dhe përzgjedhur nga Ofertuesi Potencial për zhvillimin e një Projekti si pjesë

	e Propozimit të tij të KPP në fazën e dytë të kësaj Procedure Konkurruese, faza KPP.
Ofertuesi Potencial	është personi/shoqëria ose Bashkimi i Shoqërive që do të dorëzojë një Aplikim për Kualifikim në përputhje me këto Dokumente KPK.
Aplikim për Kualifikim	është aplikimi i paraqitur në përputhje me këto Dokumente të KPK.
Afati i Dorëzimit i Aplikimit për Kualifikim	është koha dhe data e caktuar në paragrafin 1.12 të këtyre Dokumenteve të KPK.
Kriteret e Kualifikimit	janë kriteret e përcaktuara në Shtojcën 4.
Dokumentet e Kualifikimit	janë dokumentet dhe informacionet që duhet të dorëzohen nga Ofertuesi Potencial në përputhje me paragrafin 8.2 të këtyre Dokumenteve të KPK në mënyrë që të kualifikohen për të marrë pjesë në fazën e KPK.
Procedura e Kualifikimit	është Procedura e Kualifikimit e përcaktuar në Dokumentet e Procedurës së Kualifikimit.
Afati për Korrigjimet	është 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune nga Afati i Hapjes së Aplikimeve për Kualifikim apo çdo afat tjetër që do të njoftohet nga Komisioni i Posaçëm.
Kërkesë për Propozim apo KPP	Është kërkesa për propozim që do të publikohet nga MIE për Ofertuesit e Para-Kualifikuar, në fazën e KPP.
Kërkesë për Kualifikim apo KPK	Është kërkesa që përcaktohet në këto Dokumente të KPK.
Dokumentet KPP	janë dokumentet që do të publikohen nga Autoriteti Kontraktues si pjesë e Kërkesës për Propozim në fazën e dytë, faza KPP.
Dokumentet KPK	është ky dokument për Procedurën e Kualifikimit bashkë me shtojcat, siç mund të ndryshohen nga Autoriteti Kontraktues.
Ofertuesi i Përzgjedhur	është një Ofertues ose një Bashkim i Shoqërive, i përzgjedhur për të lidhur një Marrëveshje për Zhvillimin e Projektit, si rrjedhojë e vlerësimit të Aplikimeve për Kualifikim në fazën e KPP.
Vendndodhja	është vendndodhja ku do të ndërtohet Impianti.
Komisioni i Posaçëm	është komisioni i ngritur nga Autoriteti Kontraktues për

kryerjen e Procedurës së Kualifikimit në emër të Autoritetit Kontraktues, në bazë të Urdhrit të Ministrit nr. [] datë [].

SPV

është subjekti i themeluar sipas ligjit Shqiptar ku vetëm Ofertuesi i Përzgjedhur apo anëtarët e Bashkimit të Shoqërive të Përzgjedhur është / janë të vetmit përfitues / aksionar(ë) kontrollues në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të tij (në rastin e Bashkimit të Shoqërive, në përputhje me Marrëveshjen e Bashkimit të Shoqërive).

Specifikimet Teknike

janë kërkesat teknike minimale që duhet të përmbushë një Ofertues, në lidhje me Projektin, të përcaktuara në Shtojcën 7 (*Specifikimet Teknike*).

OST

është Operatori i Sistemit të Transmetimit.

1 NJOFTIMI I KËRKESËS PËR KUALIFIKIM

Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë (MIE) e Republikës së Shqipërisë po hap një proces konkurrues për impiantet për prodhimin e energjisë elektrike nga energjia e erës (eolike) me kapacitet të lartë dhe me vendndodhje në tokë¹.

MIE fton Ofertuesit Potencialë të identifikojnë dhe të propozojnë vendndodhje të përshtatshme për projektimin, financimin, ndërtimin dhe operimin e një impianti eolik të ri në tokë.

Për të ndihmuar Ofertuesit Potencialë, MIE ka porositur një analizë të përgjithshme të erës të territorit shqiptar për të treguar zonat potencialisht të përshtatshme për zhvillimin e projekteve të reja eolike si dhe zonat e papërshtatshme/të papranueshme për zhvillimin e projekteve të energjisë së erës të përcaktuara si “të kufizuara” ose “zona të ndaluara”². Studimi mund të aksesohet në faqen <https://www.infrastruktura.gov.al/shprehje-interesi/>.

Pjesëmarrja në këtë proces konkurrues lejohet vetëm për projekte me një kapacitet minimal prej 10 MW dhe kapacitet maksimal prej 75 MW. Nëpërmjet këtij procesi konkurrues MIE do të përzgjedhë Projekte me një kapacitet të përgjithshëm prej 100 MW të cilët do të përfitojnë masat mbështetëse që përshkruhen më poshtë. Autoriteti Kontraktues, më vonë mund të vendosë që të rrisë kapacitetin total të tenderuar deri në 150 MW³.

Çdo Ofertues i Përzgjedhur do të lidhë një Marrëveshje për Zhvillimin e Projektit dhe një Kontratë për Diferencë (CfD) për të shitur 100% të prodhimit të energjisë nga Projekti i tij me masa mbështetëse me çmim fiks, të barabartë me Ofertën e tij Financiare në Procedurën Konkurruese. PPA-ja do të konvertohet në një Kontratë për Diferencë (CfD) me ndodhjen e një Rasti Konvertimi (kur në Shqipëri do të jetë operacional një treg i ditës në avancë funksional, kalim që do të vendoset bazuar në kushtet të paracaktuara).

Mbështetja do të jepet direkt në formën e një Kontrate për Diferencë nëse një Vlerësim i Gatishmërisë së Tregut përfundon deri në datën e publikimit të KPP (dmth. një treg funksional i ditës në avancë dhe OER janë krijuar).

Procesi Konkurrues do të kryhet në dy faza:

- i. Kërkesa për Kualifikim (KPK) synon para-kualifikimin e Ofertuesve Potencialë që gëzojnë eksperiencën e duhur teknike, burimet financiare dhe pozitën ligjore për të përfunduar një Projekt.
- ii. Kërkesa për Propozim (KPP) gjatë së cilës secili nga Ofertuesit e Para-Kualifikuar ëdhet të provojë realizueshmërinë e projektit në vendndodhjen e propozuar dhe të dorëzojë një Ofertë Financiare.

Ky dokument rregullon procedurën e KPK.

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktues

¹ Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) ka siguruar fonde nëpërmjet një grantit për të mbështetur ankandin për energjinë e erës.

²Ju lutem vini re se studimi për vendndodhjen është përditësuar në lidhje me përcaktimin e vendndodhjeve me status Kandidat Emerald si “zonë e ndaluar”.

³ Autoriteti Kontraktues, mund të vendosë që të rrisë kapacitetin total të tenderuar deri në 150 MW në muajt e ardhshëm pas miratimit të një vendimi përfundimtar për Objektivat e vitit 2030 për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (BR).

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë
Adresa: Rr. Abdi Toptani, Nr. 8, Tiranë, Shqipëri
Tel/Faks: +355 42222245
Personi i Kontaktit: Z. Antonio Bushati
E-mail: antonio.bushati@infrastruktura.gov.al
Faqja e internetit: www.infrastruktura.gov.al

Çdo komunikim, pyetje ose kërkesë për informacion nga Ofertuesit Potencialë, në lidhje me Procedurën e KPK, do t'i drejtohet vetëm Personit të Kontaktit.

1.2 Lloji i Autoritetit Kontraktues dhe objekti i aktivitetit të tij ose aktiviteti kryesor

Institucion Qendror

1.3 Objekti i çdo Marrëveshjeje për Zhvillimin e Projektit

Projektimi, financimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e secilit Impianti tokësor me erë me kapacitet të instaluar nga 10 MW në 75 MW (përfshirë) si pjesë e masave mbështetëse, me vendndodhje në Republikën e Shqipërisë të përcaktuar nga Ofertuesi i Përzgjedhur.

Për shmangjen e dyshimeve, çdo Ofertuesi të Përzgjedhur do t'i ofrohet një Marrëveshje për Zhvillimin e Projektit që do të lidhet midis Autoritetit Kontraktues dhe Ofertuesit që paraqet Projektin.

Afati i Dokumentave të Projektit

1.4 Afati i çdo Marrëveshjeje për Zhvillimin e Projektit

Ofertuesit të Përzgjedhur do t'i ofrohet një Marrëveshje për Zhvillimin e Projektit që fillon në Datën e Hyrjes në Fuqi, dhe përfundon 15 vjet pas Datës së Operimit Tregtar. Të dhëna më të detajuara për Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit do të publikohen më vonë në fazën e KPP.

1.5 Afati i çdo Kontrate për Diferencë sipas Vlerësimit të Gatishmërisë së Tregut.

Ofertuesit të Përzgjedhur do t'i ofrohet një PPA e likuiduar fizikisht që garanton blerjen nga Blerësi të Prodhimit të Mbështetur të të gjithë Kapacitetit total kundrejt Çmimit të Energjisë Elektrike për një afat që fillon në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe përfundon 15 vjet pas Datës së Operimit Tregtar

Me ndodhjen e një Rasti Konvertimi (d.m.th. kur në Shqipëri është operacional një treg i i ditës në avancë funksional që bazohet në një proces dhe kushte të para-caktuara) Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike e lidhur fizikisht do të konvertohet në një


Kontratë për Diferencë e likujduar financiarisht. Kontrata për Diferencë duhet të garantojë pagimin e shpërblimit të ndryshueshëm simetrik mbi çmimin referencë të tregut për Prodhimin e Mbështetur sipas afateve dhe kushteve të paracaktuara.

Struktura përkatëse e kontratës dhe kushtet thelbësore për periudhën para ndodhjes së një Rasti Konvertimi jepet në Seksionin 1.5.1 dhe për periudhën pas ndodhjes së një Rasti Konvertimi jepet në Seksionin 1.5.2.

Kushtet më të detajuara të PPA dhe të konvertimit të saj në CfD do të publikohen më vonë në fazën e KPP.

Kur ka një Vlerësim të Gatishmërisë së Tregut (d.m.th ekziston rregullisht një treg i ditës në avancë funksional dhe Operatori i Energjisë së Rinovueshme) përpara datës së publikimit të KPP, Ofertuesit të Përzgjedhur do t'i ofrohet direkt një Kontratë për Diferencë pa nevojën për Konvertim. Në këtë rast, kushtet e detajuara të Kontratës për Diferencë do të publikohen direkt si pjesë e dokumentave të KPP. Autoriteti Kontraktues do të bëjë publik informacionin e nevojshëm për Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut. Ofertuesit Potencialë mund të bëjnë pyetje rreth vlerësimit të një rasti të Vlerësimit të Gatishmërisë së Tregut.


1.5.1 Struktura kontraktore përpara ndodhjes së një Rasti Konvertimi



Çështja	Parimi Kryesor
Palët e PPA	- Zhvilluesi (Shitësi) që është zgjedhur si Ofertuesi i Përzgjedhur pas fazës së KPP. - Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) apo çdo person pasues që caktohet nga Autoriteti Kompetent.
Palët e PDA	- Zhvilluesi që është zgjedhur si Ofertuesi i Përzgjedhur në fazën e KPP. - Autoriteti Kontraktues (MIE).

Çështja	Parimi Kryesor
Afati i PPA/PDA	- PPA (e konvertueshme në CfD) hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe mbaron në vitin e 15-të Datës së Operimit Tregtar. - PDA hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe mbaron në vitin e 15-të Datës së Operimit Tregtar. - PPA dhe PDA hyjnë në fuqi njëkohësisht.
Çmimi	- Çmimi i Ofertës i Ofertuesit të Përzgjedhur.
Ndërprerjet	- Shitësi do të përfitojë kompensim sipas Legjislacionit të Zbatueshëm për ndërprerjet.
Përgjegjësia për Balancimin	- Shitësi do të jetë përgjegjës për balancimin sipas Legjislacionit të Zbatueshëm. Shitësit mund t'i jepet mundësia që të hyjë në Grupin e Balancimit të Blerësit ose në Grupin e Balancimit të një pale tjetër.
Konvertimi në Kontratë për Diferencë (CfD)	- MIE do të sigurojë se Konvertimi në një CfD do të ruajë po të njëjtin ekuilibër ekonomik si në PPA. - PDA dhe PPA përcaktojnë standartet për sigurimin e një ekuilibri ekonomik dhe procesin e Konvertimit, në veçanti: - Çmimi i Energjisë Elektrike do të shërbejë si çmim fiks (strike price), - Çmimet ekuilibër i tregjeve të energjisë elektrike shërbejnë si çmime të luhatshme referencë ndaj Çmimit të Energjisë Elektrike.
Zgjidhja për mospërmblidhje e PPA / PDA	- Blerësi apo Shitësi mund ta zgjidhë PPA-në nëse Pala tjetër është në shkelje materiale të ndonjë detyrimi që nuk mund të ndreqet apo është në shkelje materiale të ndonjë detyrimi që ndreqet por që nuk është ndrequr brenda afatit të kërkesës përndreqjen e tij. Në këtë rast kjo Palë ka të drejtën e dëmshpërblimit të humbjes së pësuar nga përfundimi përpara afatit. - Blerësi /MIE mund të zgjidhin PPA-në vetëm pasi t'i kenë dhënë huadhënësve të Shitësit të drejtën për të ndërhyrë dhe të propozojnë një entitet zëvendësues në PPA/PDA sipas një marrëveshje direkte.
Legjislacioni i Zbatueshëm	- Legjislacioni i Zbatueshëm është ligji shqiptar.
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve	- PPA/PDA parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Ndërmjetësim dhe Vendim Eksperti (nëpërmjet Qendrës për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë) dhe arbitrazh ndërkombëtar sipas rregullave të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC).

1.5.2 Struktura kontraktore pas ndodhjes së një Rasti Konvertimi



Me ndodhjen e një Rasti Konvertimi, Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike me likuidim fizik duhet të konvertohet në një Kontratë për Diferencë me likuidim financiar sipas afateve dhe kushteve të paracaktuara. Ndryshimet që bëhen për Konvertimin në CfD duhet të arrijnë (për aq sa të jetë e mundur) të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, detyrimeve, risqeve dhe shpërblimeve ndërmjet palëve në lidhje me objektin e PPA sikurse janë në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi për të reflektuar Konvertimin⁴. Kjo paraqitet në grafikun në Seksionin 1.5.2 (a) dhe (b). Kushtet kryesore për PPA- dhe Konvertimin në CfD do të publikohen më vonë në fazën e KPP.

Në veçanti, në rast konvertimi në një CfD, dispozitat e PPA për livrimin dhe pagesën do të ndryshohen për të parashikuar çmimin e tregut për energjinë e prodhuar dhe ndarjen e elementit të shpërblimit të ndryshueshëm nga çmimi i tregut.

- Detyrimi i Shitësit për shitjen e të gjithë energjisë së prodhuar në Impiant në tregun e organizuar të energjisë elektrike.
- Çmimi i Energjisë Elektrike sipas PPA do të jetë si çmim fiks në CfD.
- Çmimi referencë i energjisë elektrike (EUR për MW) që do të përfshihet në CfD si çmim orar i ditës në avancë për periudhën përkatëse që do të caktohet nga burimi i çmimit referencë,
- Nga krahasimi midis çmimit fiks dhe çmimit referencë, pagesa e diferencës së çmimit / shpërblimit nga pala e CfD tek Shitësi apo anasjelltas.
 - Pala e CfD do t'i paguajë Shitësit shumën e barabartë me diferencën (nëse diferenca është pozitive) midis Çmimit të Energjisë Elektrike të Kontratës/ Çmimit fiks dhe Çmimit Referencë të Energjisë Elektrike shumëzuar me Prodhimin e caktuar, apo
 - Shitësi do t'i paguajë palës së CfD shumën e barabartë me diferencën (nëse diferenca është negative) midis Çmimit fiks dhe Çmimit Referencë të Energjisë

⁴Per te implementuar nje Konvertim, me ndodhjen e një Rasti Konvertimi, secila Palë mund të njoftojë Palën tjetër duke kërkuar që Palët të takohen për të diskutuar Konvertimin dhe, në mirëbesim, do të përpiqen të bien dakord për ndryshimet e nevojshme që duhet të bëhen në PPA për të arritur (per aq sa të jetë e mundur) të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, detyrimeve, risqeve dhe shpërblimeve ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e PPA sikurse zbatohet në Datën e Hyrjes në Fuqi për të reflektuar Konvertimin.

Në qoftë se Palët nuk janë në gjendje të bien dakord për ndryshimet e Konvertimit atëherë secila Palë do ta dërgojë çështjen për vendim në Qendrën për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për përcaktimin e ndryshimeve që duhet t'i bëhen për Konvertimin në CfD që janë të nevojshme për të arritur (per aq sa të jetë e mundur) Konvertimin duke ruajtur të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, përgjegjësi, risqeve dhe shpërblimeve ndërmjet Palëve lidhur me objektin e PPA sikurse zbatohet në Datën e Hyrjes në Fuqi. Nëse një çështje nuk zgjidhet brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh Pune (apo brenda një kohe të pranuar nga Palët) nga referimi për ndërmjetësim në Qendrën për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, secila nga Palët mund të nisë procedurat për arbitrazh ndërkombëtar në përputhje me dispozitën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

1.6 Vendndodhja

Vendndodhjet do të identifikohen dhe propozohen nga Ofertuesit Potencialë në përputhje me kriteret që përcaktohen në paragrafin 10.1

1.7 Lidhja me Rrjetin e Transmetimit

Bazuar në Ligjin 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, infrastruktura e lidhjes së rrjetit (që përfshin ndërtimin e nënstacionit, linjën e tensionit të lartë dhe linjën tek pika e lidhjes me rrjetin) duhet të realizohet nga Zhvilluesi.

Moduli i transformatorit në nënstacionin e parkut eolik dhe modulet e linjave kryesore të energjisë duhet të kenë të gjithë elementët e nevojshëm kryesorë dhe mbështetës sipas standarteve të OST-së.

Zbatimi i plotë i projektit që përfshin nënstacionin në parkun eolik, linjat kryesore të energjisë dhe modulën e linjave në pikën e lidhjes me rrjetin duhet të miratohet nga OST përpara se të fillojë zbatimi i projektit. Zhvilluesi duhet të zbatojë të gjithë kushtet teknike të dizenjës dhe të përdorimit të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike në këtë investim. OST do të mbikqyrë në të gjithë fazat e zbatimit të projektit të infrastrukturës lidhëse së këtij investimi pjesën që lidhet me rezultatin e linjave dhe impantin e tensionit të lartë deri në testimin final të tij.

OST ka akses të plotë që në të ardhmen të zgjerojë nënstacionin e ri afër parkut eolik në Vendndodhjen e Përzgjedhur me një dalje të re me tension të lartë për nevojat e zhvillimit të sistemit të transmetimit.

Të dhënat teknike për pajisjen me tension të lartë që do të përdoret si edhe sistemi i kontrollit dhe i mbrojtjes i transformatorit/ve që do të ngrihen dhe rezultatet e linjave do të jenë në përputhje të plotë me standartet më të fundit të publikuara të KEN dhe SE. Specifikimet teknike të pajisjes dhe ato të mbrojtjes së kontrollit të elementëve mbështetës 110 kV duhet të jenë në përputhje të plotë me parametrat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe të jenë miratuar nga OST.

Pikat e matjes së energjisë elektrike që parku eolik do të fusë në Rrjetin e Transmetimit do të jenë në daljen me tension të lartë të transformatorit(rëve)110 / TM që do të instalohen dhe duhet të jenë në përputhje me standartet e Kodit të Rrjetit të Transmetimit/Kodin e Matjes.

Zhvilluesi do të mbulojë kostot për ndërtimin e Rrjetit të Transmetimit dhe të lidhjes me rrjetin në pikën e lidhjes që do të zgjidhet nga Ofertuesi i Përzgjedhur. OST do të mbulojë kostot e përforcimit të rrjetit nëse ka.

1.8 Afati Kohor për Kryerjen e Punimeve:

Afati Kohor për Kryerjen e Punimeve do të përcaktohet në draftin e Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit që do të publikohet në fazën e KPP.

1.9 Informacioni Ligjor, Ekonomik, Financiar dhe Teknik (Dokumentet e Kualifikimit)

Siç përcaktohet në Seksionin 8 dhe Shtojcën 4 dhe 4/1 të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

Vetëm Ofertuesit e Para-Kualifikuar do të vazhdojnë në fazën e KPP.

1.10 Procedura Konkurruese

E hapur

1.11 Afati i Dorëzimit të Aplikimeve për Kualifikim

Data: 13 Qershor 2022

Ora: 18:00 Ora e Europës Qendrore

Nëse Aplikimi për Kualifikim do të dorëzohet me postë, ajo do të quhet se është dorëzuar rregullisht në Afatin e Dorëzimit të Aplikimeve për Kualifikim nëse plotëson në mënyrë kumulative kushtet më poshtë:

- data që shënohet në zarf, konfirmuar nga vërtetimi postar duhet të jetë jo më vonë se Afati për Dorëzimin të Aplikimeve për Kualifikim (*d.m.th 13 Qershor 2022, Ora: 18:00 Ora e Europës Qendrore*);

- MIE merr Aplikimin për Kualifikim jo më vonë se Data për Hapjen e Aplikimeve për Kualifikim (*d.m.th [20 Qershor 2022, Ora: 12:00 Ora e Europës Qendrore]*)

MIE do të lëshojë konfirmimin e marrjes së Aplikimit për Kualifikim, me datën dhe orën e marrjes. Aplikimet për Kualifikim që dorëzohen dorazi pas Afatit të Dorëzimit apo Aplikimet për Kualifikim që dorëzohen me postë që nuk plotësojnë në mënyrë kumulative kushte e mësipërme nuk do të shqyrtohen. Ato do t'i kthehen Ofertuesve Potencialë pa u hapur.

1.12 Hapja e Aplikimeve për Kualifikim

Datë: [20 Qershor 2022

Ora: 12:00 Ora e Europës Qendrore]

Informacioni i komunikuar përgjatë hapjes publike të Aplikimeve për Kualifikim të dorëzuara nëpërmjet mjeteve elektronike, do t'u komunikohet, me kërkesë të tyre, të gjithë Ofertuesve Potencialë që kanë dorëzuar një Aplikim për Kualifikim.

1.13 Gjuha

Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këto Dokumente të KPP dhe kërkesave për Noterimet, Legalizimet dhe Përkthimet në Shtojcën 4, gjuha e Aplikimeve për Kualifikim do të jetë gjuha shqipe ose angleze. Nëse dokumentacioni është dorëzuar në gjuhën angleze, Ofertuesi Potencial është i detyruar të dorëzojë gjithashtu një përkthim të certifikuar dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhje apo paqartësie, përkthimi në gjuhën shqipe do të përdoret për interpretimin e informacionit dhe çdo paqartësie. Dokumentet e KPP do t'u jepen Ofertuesve Potencialë të interesuar, në gjuhën shqipe dhe angleze dhe në rast mospërputhje, gjuha shqipe do të mbizotërojë.

1.14 Data e Shpalljes së Njoftimit të Procedurës së Kualifikimit

Data: [15 Qershor 2021]

1.15 Data e Konferencës për Ofertuesit Potencialë

Në përputhje me Kalendarin e Parashikuar (Shtojca 13).

1.16 Njoftimet / korrespondenca

Të gjitha dhe çdo korrespondencë e njoftim ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Ofertuesve Potencialë do të bëhen në mënyrë elektronike, në adresën e e-mailit të Personit të Kontaktit, ashtu siç specifikohet në paragrafin 1.1.1. dhe adresën e e-mailit të Kontaktit të Ofertuesit Potencial, ashtu siç specifikohet në paragrafin 1.1.16. Njoftimet e bëra nga njëra palë tek tjetra, do të konsiderohen të marra, në momentin e dërgimit të tyre elektronik (nëpërmjet e-mailit) nga pala dërguese.

Autoriteti Kontraktues në diskrecionin e tij, mund të zgjedhë që informacione, apo dokumenta të caktuara, ti dërgohen atij në adresën e tij në kopje fizike.

DOKUMENTET E KPK - UDHËZIME PËR OFERTUESIT POTENCIALË

2 HYRJE

Në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.06.2018 *“Për miratimin e masave mbështetëse për promovimin e përdorimit të elektricitetit nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe procedurat për përzgjedhjen e projekteve për përfitim të tyre”* dhe urdhrit të Ministrit nr. 336/1, datë 20.12.2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur zbatimin e projektit për *“Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen e disa Impianteve Eolike tokësore secili me një kapacitet të instaluar midis 10 dhe 75 MW (përfshirë), të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhurë nga Ofertuesi në Republikën e Shqipërisë”*. Kapaciteti i instaluar do të përfitojë nga masat e miratuara nga Këshilli i Ministrave me Vendim Nr. 349, datë 12.06.2018 dhe një PPA oaw Kontratë për Diferencë, sipas rastit.

Përzgjedhja e Ofertuesve të Para-Kualifikuar do të bëhet në bazë të Procedurës së Kualifikimit në përputhje me kriteret e kualifikimit dhe vlerësimit të përcaktuara në këtë dokument.

Ofertuesit Potencialë ftohen me anë të kësaj të dorëzojnë një Aplikim për Kualifikim i cili plotëson kërkesat e këtyre Dokumenteve të KPK. Ofertuesit Potencialë do të plotësojnë Shtojcat përkatëse të bashkëlidhura në këto Dokumente të KPK .

2.1 Baza Ligjore

Procedura Konkruente është organizuar në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.06.2018 *“Për miratimin e masave mbështetëse për promovimin e përdorimit të elektricitetit nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe procedurat për përzgjedhjen e projekteve për përfitim të tyre”*, me ndryshime.

3 PROCEDURA KONKURUESE

3.1 Sqarimi i pyetjeve dhe Ndryshimet

- 3.1.1 Çdo Ofertues që kërkon sqarime mbi këto Dokumente të KPK mund të dërgojë një kërkesë për sqarim, jo më vonë se data [12 Maj 2022], elektronikisht me email drejtuar Personit të Kontaktit të Autoritetit Kontraktues.
- 3.1.2 Përgjigjja ndaj këtyre kërkesave për sqarim, duke përfshirë një shpjegim të pyetjes por pa identifikuar burimin e saj, do të postohet për të gjithë Ofertuesit Potencialë në raunde të rregullta (p.sh të paktën një herë në muaj, në varësi të numrit të kërkesave) nga Data e Shpalljes. Nëse e konsideron të përshtatshme apo të nevojshme, Komisioni i Posaçëm mund të zgjedhë por pa qenë i detyruar që të postojë përgjigjet ndaj kërkesave për sqarim përpara raundit përkatës. Autoriteti Kontraktues mund të zgjedhë të japë një përgjigje të vetme ndaj një grupi kërkesash të ngjashme.
- 3.1.3 Një Ofertues Potencial mund të propozojë ndryshime dhe/ose korrigjime në këto Dokumente të KPK së bashku me një shënim të veçantë, ku shpjegohen arsyet për çdo ndryshim dhe/ose korrigjim.
- 3.1.4 Ndryshimet/korrigjimet e këtyre Dokumenteve të KPK, të propozuara nga Ofertuesit Potencialë, do t'i dërgohen elektronikisht, me e-mail, Personit të Kontaktit, jo më vonë se data [17 Janar 2022]. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos i pranojë ndryshimet e propozuara të Dokumenteve të KPK .
- 3.1.5 E drejta e Ofertuesve Potencialë për të ndryshuar Dokumentet e KPK , në përputhje me nenet 3.1.3 dhe 3.1.4 nuk interpretohet si e drejtë e Ofertuesit Potencial për të kundërshtuar këto Dokumente të KPK. Për shmangjen e dyshimit, e drejta e Ofertuesve Potencialë për të ndryshuar Dokumentet e KPK në përputhje me paragrafin 3.3 më poshtë, nuk do të interpretohet si e drejtë e Ofertuesve Potencialë për të dorëzuar një Aplikim për Kualifikim që kushtëzohet nga pranimi i këtyre ndryshimeve.
- 3.1.6 Nëse zbatohet, versionet e ndryshuara të Dokumenteve të KPK, do tu vihen në dispozicion të gjithë Ofertuesve Potencialë, përpara Afatit të Dorëzimit të Aplikimeve për Kualifikim, dhe në këtë rast ato do të jenë detyruese për Ofertuesit Potencialë. Asnjë komunikim, i çfarëdolloj natyre, përfshirë por pa u kufizuar përgjigjet ndaj pyetjeve apo kërkesave për sqarim, nuk do të konsiderohet se përbën ndryshim të këtyre Dokumenteve të KPK.
- 3.1.7 Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë kryesisht, në çdo kohë dhe për çdo arsye, këto Dokumente të KPK (duke përfshirë Shtojcat dhe Anekset). Versionet e ndryshuara do t'i komunikohen të gjithë Ofertuesve Potencialë dhe do të konsiderohen si Dokumentet përfundimtare të KPK për këtë Procedurë të Kualifikimit. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues, në diskrecionin e tij, mund të zgjasë Afatin e Dorëzimit dhe të njoftojë Afatin e ri të Dorëzimit, nëse i aplikohet.

3.2 Kalendari i Parashikuar

- 3.2.1 Kalendari i Parashikuar i Procedurës të Kualifikimit jepet i detajuar në Shtojcën 13 (*Kalendari i Parashikuar*).
- 3.2.2 MIE mund të ndryshojë Kalendarin e Parashikuar sipas diskrecionit të saj. Në këtë rast, MIE do të njoftojë menjëherë Ofertuesit Potencialë për ndryshimet e bëra në Kalendarin e Parashikuar.

3.3 Konferenca për Ofertuesit Potencialë

MIE do të organizojë një Konferencë për Ofertuesit Potencialë në datën [2021] për nxitjen e angazhimit dhe pjesëmarrjes në Procedurën Konkurruese. Kjo përfshin pa u kufizuar ë shpjegimin e kriterëve të Dokumenteve të KPK dhe të fazës së dytë të KPP si dhe përgjigje ndaj pyetjeve të përzgjedhura me interes të Ofertuesve Potencialë.

Kalendari i Konferencës dhe opsionet për të depozituar pyetjet do të njoftohet Ofertuesve Potencialë. MIE mund të organizojë edhe Konferenca të tjera. Pjesëmarrja e Ofertuesve Potencialë në Konferencë bëhet me koston, riskun dhe nën përgjegjësinë e tyre të vetme.

3.4 Kërkimet dhe studimet e Ofertuesve Potencialë (*DueDiligence*)

Çdo Ofertues Potencial do të jetë vetë përgjegjës për të kryer kërkimin e tij të pavarur, due diligence-en dhe çdo punë ose hetim tjetër dhe për të kërkuar konsulencën e pavarur të nevojshme apo të dëshirueshme për përgatitjen e Aplikimit për Kualifikim të tij.

3.5 Konfidencialiteti i Aplikimit për Kualifikim

- 3.5.1 Çdo material, dokument, akt ose deklaratë me shkrim që përmban çdo informacion, do të konsiderohet si konfidencial sipas legjislacionit në fuqi, vetëm nëse:
- për nga natyra e tij është konfidencial;
 - është vendosur të mbetet konfidencial.
- 3.5.2 Ofertuesit Potencialë duhet të identifikojnë qartë çdo dokument ose informacion që ata dëshirojnë të mbetet konfidencial, duke plotësuar formularin e dhënë në Shtojcën 1 (*Lista e Informacionit Konfidencial*).
- 3.5.3 Nëse nuk parashikohet me ligj, vendim gjykatë ose nga Dokumentet e KPK, asnjëra nga palët nuk mund të bëjë publik informacionin teknik, informacionin për çmimet ose ndonjë informacion tjetër në lidhje me Procedurën e Kualifikimit, pa marrë miratim paraprak.
- 3.5.4 Autoriteti Kontraktues nuk konsiderohet se ka shkelur detyrimet e ruajtjes së konfidencialitetit që ka ndaj një Ofertuesi Potencial, në rastin kur:
- Autoriteti Kontraktues i jep të dhënat punëmarrësve, konsulentëve ose nën

kontraktuesëve vetëm në lidhje me Procedurën e Kualifikimit ose për t'u përgatitur për një kontratë apo për ta administruar atëkontratë;

- Informacioni i jepet personelit të Autoritetit Kontraktues për të bërë të mundur administrimin dhe kontrollin efektiv të Procedurës së Kualifikimit;
- Informacioni është lëshuar nga Komisioni i Posaçëm për mundësuar vlerësimin e Aplikimeve për Kualifikim;
- Informacioni është lëshuar nga Autoriteti Kontraktues në përgjigje të një kërkesë nga një komision i Parlamentit të Shqipërisë;
- Informacioni është lëshuar nga Autoriteti Kontraktues brenda Qeverisë së Shqipërisë ose te një Departamenti apo Agjencie tjetër Qeveritare, në përputhje me interesin legjitim të Qeverisë së Shqipërisë dhe të Autoritetit Kontraktues;
- Informacioni është kërkuar të jepet sipas ligjit.

3.6 Konfidencialiteti i informacionit të Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që i gjithë informacioni shkresor (qoftë ose jo konfidencial) dhe pavarësisht mënyrës në të cilën iu është dhënë Ofertuesve Potencialë:

- t'i rikthehet Autoritetit Kontraktues – në këtë rast, i gjithë informacioni kthehet menjëherë nga Ofertuesi Potencial në adresën e cilësuar nga Autoriteti Kontraktues; ose
- të asgjësohet nga Ofertuesi Potencial – në këtë rast, Ofertuesit Potencialë duhet të asgjësojnë menjëherë të gjithë informacionin dhe t'i japin Autoritetit Kontraktues provë me shkrim se e kanë asgjësuar informacionin.

3.7 Përdorimi i dokumenteve të Aplikimit për Kualifikim

3.7.1 Të gjithë Aplikimet për Kualifikim bëhen pronë e Autoritetit Kontraktues.

3.7.2 Pavarësisht nga sa më sipër dhe pa paragjykuar ndonjë marrëveshje vijuese të lidhur midis Autoritetit Kontraktues dhe çdo Ofertuesi Potencial, zotërimi i të drejtave të pronësisë intelektuale, në lidhje me informacionin e dhënë në Aplikimin për Kualifikim mbetet i pandryshuar.

3.7.3 Autoriteti Kontraktues mund të përdorë të dhënat e një propozimi ose të dhënat e ofruara nga një Ofertues Potencial për qëllime të Procedurës së Kualifikimit (përfshirë përgatitjen ose administrimin e çdo kontrate ose marrëveshjeje).

3.7.4 Autoriteti Kontraktues do t'i trajtojë Ofertuesit Potencialë në mënyrë të barabartë gjatë Procedurës së Kualifikimit, duke respektuar konfidencialitetin dhe informacionin e dhënë prej

tyre.

3.8 Përhapja e informacionit

Ofertuesi Potencial nuk do të bëjë asnjë deklaratë apo nuk do të lëshojë asnjë dokument apo material, e as nuk do të japë asnjë informacion për publikim në asnjë media, në lidhje me Procedurën se Kualifikimit, vlerësimin e Aplikimeve për Kualifikim, pranimin e ndonjë Aplikimi për Kualifikim, zhvillimin e negociatave apo njoftimin e caktimit të Ofertuesit të Para-Kualifikuar, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

3.9 Të drejta shtesë të Autoritetit Kontraktues

3.9.1 Pa u kufizuar në të drejtat e tjera që ka gjatë Procedurës se Kualifikimit, Autoriteti Kontraktues mundet por pa qenë i detyruar që në çdo kohë, dhe pa dhënë asnjë arsye:

- t'u japë informacione dhe sqarime shtesë të gjithë Ofertuesve Potencialë;
- të kërkojë informacion ose sqarim të mëtejshëm nga çdo Ofertues Potencial lidhur me Aplikimin e tij për Kualifikim;
- të kërkojë nga çdo Ofertues Potencial informacion apo dokumentacion shtesë për Aplikimin e tij për Kualifikim;
- të kërkojë ndryshime në strukturën organizative të propozuar të Bashkimit të Shoqërive nëse e konsideron të nevojshme sipas marrëdhënies të bashkimit të shoqërive dhe të grupit të shoqërive dhe të kritereve të përgjegjësisë e të përmbytjes thelbësore të Aplikimit për Kualifikimë;
- të kërkojë nga çdo Ofertues Potencial të sqarojë dokumentet e tij mbështetëse me informacion shtesë apo nëse e nevojshme me dokumente shtesë ,me kusht që informacioni nuk do të ndryshojë thelbësisht Aplikimin për Kualifikim;
- të korrigjojë gabime të dukshme kozmetike në Aplikimin për Kualifikim pas konfirmimit të korrigjimit nga Ofertuesi Potencial, me kusht që informacioni nuk do të ndryshojë thelbësisht Aplikimin për Kualifikimn;
- t'i përgjigjet çdo pyetjeje që i është drejtuar Autoritetit Kontraktues për sqarim, nga Ofertuesit Potencialë dhe të publikojë pyetjen dhe përgjigjen me e-mail;
- të përsërisë, të pezullojë, të ribëjë ose të përfundojë Procedurën e Kualifikimit sipas shkaqeve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

3.9.2 Ofertuesit Potencialë heqin dorë nga e drejta e tyre për të ngritur çfarëdo pretendimi ndaj MIE, Komisionit të Posaçëm, Qeverisë Shqiptare apo nëpunësve, kontraktuesve, punëmarrësve, agjentëve ose këshilltarëve të tyre, në lidhje me ushtrimin ose mosushtrimin e të drejtave të përcaktuara në këtë paragraf 3.9.

3.10 Informacioni i rremë

Çdo Ofertues Potencial që jep informacion të rremë mund të përjashtohet nga Procedura e Kualifikimit në çdo kohë. Nëse dhënia e informacionit të rremë konstatohet pas kualifikimit apo zgjedhjes për të kaluar në fazën e dytë të KPP, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përjashtojë Ofertuesin Potencial nga faza e KPP, apo pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit mund ta zgjidhë Marrëveshjes për Zhvillimin e Projekti në përputhje me kushtet e saj. Ofertuesit Potencialë duhet të përdorin këto Dokumente të KPK pa ndryshuar përmbajtjen e tyre. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhënia e informacioneve të rreme, përpilimi i dokumenteve të rreme apo te falsifikuara si dhe çdo deklaratë apo ndonjë e dhënë tjetër të rremë ose të falsifikuar, konsiderohet vepër penale.

3.11 Konflikti i interesit

Rastet e konfliktit të interesit do të trajtohen në përputhje me ligjin 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3.12 Veprimet e Kundraligjshme

3.12.1 Në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues e refuzon një Aplikim për Kualifikim, nëse Ofertuesi Potencial që e ka paraqitur atë:

- i ka dhënë ose synon t’i japë një punonjësi aktual apo të mëparshëm të Autoritetit Kontraktues, një dhuratë në para ose në forma të tjera, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim përgjatë Procedurës së Kualifikimit;
- ka një konflikt interesi ose mosmarrëveshje të pazgjidhur në lidhje me Procedurën e Kualifikimit;ose
- ka dorëzuar dokumente/informacione të rreme që lidhen me kërkesat e paraqitura në Dokumentet e KPK.

3.12.2 Asnjë Ofertues Potencial (duke përfshirë agjentët dhe përfaqësuesit e tij) nuk duhet të kontaktojë apo të tentojë të kontaktojë anëtarët e Autoritetit Kontraktues, ndonjë anëtar të Komisionit të Posaçëm, apo anëtar apo punonjës të Qeverisë së Shqipërisë ose të departamenteve, ministrive, agjencive apo organeve ekzekutive të saj, në lidhje me Procedurën Konkurruese, përveçse sipas procedurës së përcaktuar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese.

3.12.3 Autoriteti Kontraktues do të njoftojë me shkrim Ofertuesit Potencialë dhe çdo institucion të Qeverisë së Shqipërisë, për çdo veprim të kundraligjshëm të Ofertuesit dhe do të përfshijë çdo njoftim në raportin për Procedurën e Kualifikimit.

3.13 Kostot

3.13.1 Çdo Ofertues Potencial do të përballojë kostot dhe shpenzimet e veta në lidhje me

përgatitjen dhe dorëzimin e Aplikimit të tij për Kualifikim.

3.14 Konsorciumi ose Bashkimi i Shoqërive

3.14.1 Një Ofertues Potencial mund të marrë formën e një bashkimi shoqërisht (“**Bashkim Shoqërisht**”) të përbërë nga dy ose më shumë shoqëri, korporata apo persona të tjerë juridikë.

3.14.2 Çdo Bashkim Shoqërisht duhet të caktojë dhe të autorizojë një anëtar kryesues (“**Anëtari Kryesues**”) për të përfaqësuar dhe për tu zotuar në mënyrë të parevokueshme për të gjithë anëtarët e Bashkimit të Shoqërive, në të gjitha çështjet lidhur me Procedurën Konkurruese.

3.14.3

Asnjë person nuk mund të marrë pjesë në dy ose më shumë Aplikime për Kualifikim, qoftë individualisht apo si anëtar i një Bashkimi Shoqërisht.

3.14.4 Asnjë Ofertues apo anëtar i një Bashkimi Shoqërisht nuk mund të ushtrojë kontroll mbi një Ofertues tjetër apo mbi një anëtar të një Bashkimi Shoqërisht

3.15 Përputhshmëria me Dokumentet e KPK

Çdo Ofertues Potencial duhet të marrë në konsideratë udhëzimet, kriteret, kushtet, përcaktimet, afatet dhe të gjithë informacionin në Dokumentet e KPK. Në rast se Ofertuesi Potencial:

- nuk plotëson të gjithë dokumentacionin dhe informacionin në Dokumentet e KPK-se; ose
- paraqet një Aplikim për Kualifikim i cili nuk është në përputhje me kushtet dhe kërkesat e Dokumenteve të KPK; ose
- paraqet një Aplikim për Kualifikim, që devijon nga struktura e propozuar në këtë Procedurë të Kualifikimit, e cila nuk është korrigjuar gjatë Procedurës të Korrigjimit.

Autoriteti Kontraktues do të përcaktojë se Aplikim për Kualifikim nuk është në përputhje me kërkesat e Dokumenteve të KPK dhe do të refuzojë Aplikim për Kualifikim.

4 PËRGATITJA E APLIKIMEVE PËR KUALIFIKIM

4.1 Përmbajtja e Aplikimit për Kualifikim

Aplikimi për Kualifikim duhet të përfshijë Dokumentet e Kualifikimit, në përputhje me kërkesat e Seksionit 8 dhe Shtojcërës 4 dhe 4/1.

4.2 Gjuha e Aplikimit për Kualifikim

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, Ofertuesit Potencialë do ti përgatisin Dokumentet e Aplikimit për Kualifikim në gjuhën shqipe ose angleze. Nëse Dokumentet e Aplikimit për Kualifikim janë në gjuhën angleze, ato duhet të shoqërohen nga përkthimi i certifikuar dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Broshurat që janë pjesë e Dokumenteve të Aplikimit për Kualifikim, mund të dorëzohen në gjuhën angleze ose në një gjuhë tjetër të huaj, të shoqëruar nga përkthimi i noterizuar i pjesëve përkatëse në anglisht ose në shqip.

4.3 Referenca të qarta

- 4.3.1 Ofertuesit Potencialë duhet të përfshijnë në çdo dokument një referim të qartë në faqen dhe paragrafin përkatës të Dokumenteve të KPK.
- 4.3.2 Çdo informacion financiar në lidhje me Procedurën e Kualifikimit duhet të shprehet në monedhën Euro. Nëse elemente të Aplikimit për Kualifikimës paraqiten në një monedhë të huaj, të ndryshme nga Euro, ajo vlerë do të vlerësohet duke iu referuar monedhës Euro. Të gjitha vlerat do të konvertohen sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës Qendrore Europiane, të zbatueshëm në ditën e shpalljes së njoftimit të këtyre Dokumentave të KPK.

5 DORËZIMI I APLIKIMI PËR KUALIFIKIMVE

5.1 Afati i Dorëzimit i Aplikimit për Kualifikim

5.1.1 Afati i Dorëzimit i Aplikimeve për Kualifikim është:

Data: [13 Qershor 2022]

Ora: 18:00 Ora e Europës Qendrore

5.1.2 MIE, në diskrecionin e saj, mund të shtyjë Afatin e Dorëzimit të Aplikimit për Kualifikim duke i dhënë njoftim të gjithë Ofertuesve Potencialë.

5.2 Forma e Dorëzimit

521 Ofertuesit Potencialë do të dorëzojnë Dokumentet e Aplikimit për Kualifikim në adresën si vijon: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. Abdi Toptani, nr. 8, Tiranë, Shqipëri, jo më vonë se data dhe ora siç përcaktohet në nenin 5.1.1, në kopje fizike dhe elektronike.

522 Nëse Aplikimi për Kualifikim do të dorëzohet me postë, ajo do të quhet se është dorëzuar rregullisht në Afatin e Dorëzimit të Aplikimit për Kualifikim nëse plotëson në mënyrë kumulative kushtet më poshtë:

- data që shënohet në Zarf, konfirmuar nga vërtetimi postar duhet të jetë jo më vonë se Afati për Dorëzimin e Aplikimit për Kualifikim (*d.m.th [13 Qershor 2022, Ora: 18:00 Ora e Europës Qendrore];*)
- MIE merr Aplikimin për Kualifikimn jo më vonë se Data për Hapjen e Aplikimit për Kualifikim (*d.m.th [20 Qershor 2022, Ora: 12:00 Ora e Europës Qendrore];*)

Aplikimet për Kualifikim të paraqitura dorazi pas Afatit të Dorëzimit apo Aplikimet për Kualifikim të dorëzuar me email që nuk plotësojnë në mënyrë kumulative kushtet më sipër do të refuzohen. Ofertuesit Potencialë do të dorëzojnë vetëm një Aplikim për Kualifikim.

523 Kërkesat për sqarim në lidhje me dorëzimin elektronik të Dokumenteve të Aplikimit për Kualifikim do t'i paraqiten Personit të Kontaktit, jo më vonë se data [12 Maj 2022].

524 Dokumentet e KPK të Ofertuesve Potencialë do të dorëzohen në origjinal, sipas kërkesave të parashikuara në këto Dokumente të Kualifikimit. Secila faqe e dokumentave të përmbajtura në Aplikimin për Kualifikim origjinal duhet të numërohen njëra pas tjetrës dhe të siglohen nga Përfaqësuesi Autorizuar i Ofertuesit Potencial.

525 Të gjitha shifrat e shprehura në Aplikimin për Kualifikim duhet të shprehen në numra dhe në fjalë sipas formatit “1,000 (një mijë) (p.sh. tre milion: 3,000,000)” dhe në rast mospërputhjeje, fjalët kanë përparësi ndaj numrave.

526 Çdo Dokument origjinal i Aplikimit për Kualifikim duhet të jetë i shtypur dhe i shkruar me bojë që nuk fshihet. Kopja fizike duhet të shoqërohet me kopje elektronike të

Dokumenteve të Aplikimit për Kualifikim të ruajtur në USB. Përfaqësuesi i Autorizuar i Ofertuesit Potencial do të nënshkruajë Dokumentet origjinale fizike (*hard-copy*) të Aplikimit për Kualifikim dhe do t'i siglojë në çdo faqe, me përjashtim të literaturës së pandryshuar ekzistuese. Dokumentet e Aplikimit për Kualifikim nuk duhet të kenë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtën e nënshkrimit të Dokumenteve të Aplikimit për Kualifikim.

- 527 Të gjitha dokumentat që do të dorëzohen nga Ofertuesi Potencial, duhet të vendosen në një zarf të mbyllur dhe të vulosur (Zarfi 1), dhe do të ruhen në USB të dedikuar që do të vendoset në një zarf të veçantë të mbyllur dhe të vulosur (Zarfi 2) që do të dërgohet bashkë me Zarfin 1. Zarfi 1 dhe USB e vendosur në Zarfin 2 do të vendosen në një zarf të tretë të mbyllur dhe të vulosur (Zarfi 3), i cili do të dorëzohet nga Ofertuesi Potencial. Për qëllim qartësie, Ofertuesit Potencialë duhet të dorëzojnë vetëm Zarfin 3, i cili duhet të përmbajë brenda tij Zarfin 1 dhe Zarfin 2 me USB që përmban versionin elektronik të të gjithë Dokumenteve të Aplikimit për Kualifikimë.
- 528 Zarfi 1 duhet të përmbajë të gjitha Dokumentet e Kualifikimit ëqë specifikohen në Dokumentet e KPK dhe veçanërisht në Shtojcën 4. USB duhet të përmbajë po të njëjtat dokumente në format elektronik.
- 529 Secili Zarf duhet të ketë (i) emrin dhe adresën e Ofertuesit Potencial/Bashkimit të Shoqërive (dhe anëtarëve të saj); (ii) emrin dhe adresën e Autoritetit Kontraktues; dhe (iii) shënimin: “Aplikimi për Kualifikim për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen e Impiantit eolik tokësor me kapacitet të instaluar midis 10 MW dhe 75 MW (përfshirë) të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga Ofertuesi në Republikën e Shqipërisë”. Zarfi 3 duhet të ketë të shënuar në mënyrë të qartë: “Mos e hap, përveç rasteve kur është prezent Komisioni i Posaçëm dhe jo përpara datës [20 Qershor 2022, ora 12:00 CET]”.

6 TËRHEQJA E APLIKIMEVE PËR KUALIFIKIM

6.1 Kërkesat për informacion shtesë

Ofertuesi Potencial do të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues kur mendon se ka mospërputhje, gabime, apo paqartësi në Procedurën e Kualifikimit, në Dokumentet e KPK ose në çdo informacion të dhënë nga Autoriteti Kontraktues, në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të bëjë korrigjimet që gjykon me vend.

6.2 Tërheqja e Aplikimeve për Kualifikim

Ofertuesi Potencial mund të tërheqë Aplikimin e tij për Kualifikim, pa penalitete, pasi e ka dorëzuar, me kusht që Autoritetit Kontraktues t'i dërgohet njoftim për tërheqjen, përpara Afatit të Dorëzimit të Aplikimeve për Kualifikim.

6.3 Gabimet jo-thelbësore, të paqëllimshme, parregullsi apo mungesë informacioni në Aplikim për Kualifikim

Autoriteti Kontraktues mund t'u kërkojë Ofertuesve Potencialë që të bëjnë ndryshime, të japin informacion shtesë në formën e duhur brenda afatit të komunikuar nga Komisioni i ëPosaçëm apo të bëjnë korrigjime apo ndryshime të dokumenteve mbështetëse për brenda Afatit për Korrigjime sipas paragrafit 7.3. (ky proces do të referohet **“Korrigjim”**) me kusht që gjatë procedurës së Korrigjimit, Autoriteti Kontraktues do të garantojë trajtim të barabartë e të ndershëm të Ofertuesve Potencialë dhe tu japë Ofertuesve Potencialë në pozita të barabarta mundësi të barabarta për të bërë ndryshime dhe korrigjime të ngjashme por që procedura e Korrigjimit nuk duhet të ndryshojë thelbësisht Aplikimin për Kualifikim.

Autoriteti Kontraktues mund të korrigjojë gabime të dukshme kozmetike (jo-thelbësore) në Aplikimin për Kualifikim pas konfirmimit të Ofertuesit Potencial për korrigjimin brenda Afatit për Korrigjimet.

Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këto Rregulla të KPK, Autoriteti Kontraktues nuk do të pranojë asnjë ndryshim apo shtesë tjetër në Aplikimin për Kualifikim pas korrigjimit në Fazën e Kualifikimit. Autoriteti Kontraktues nuk do të mbajë përgjegjësi për humbjet apo pasojat që vijnë nga gabimet në Aplikimin për Kualifikim.

7 RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E APLIKIMEVE PËR KUALIFIKIM

- 7.1 Pas mbarimit të Afatit të Dorëzimit të Aplikimeve për Kualifikim, Komisioni i Posaçëm do të bëjë identifikimin e Ofertuesve Potencialë dhe do të hapë Aplikimet për Kualifikim të dorëzuara pranë Autoritetit Kontraktues.
- 7.2 Aplikimet për Kualifikim do të kualifikohen në përputhje me kriteret dhe rregullat e Seksionit 8. Ofertuesit e Para-Kualifikuar do të vazhdojnë më tej në fazën e KPP dhe do të vlerësohen në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara në Dokumentet e KPP.
- 7.3 Komisioni i Posaçëm kur e sheh me vend ose të nevojshme, por pa qenë i detyruar, mund të kërkojë sqarime apo informacion shtesë me shkrim me e-mail nga Ofertuesi Potencial, si më poshtë. Kurdo të bëhet një kërkesë e tillë, Ofertuesi Potencial duhet t'i paraqesë Komisionit të Posaçëm sqarimet me shkrim apo informacionin apo dokumentet shtesë që mungojnë brenda datës dhe sipas formës së caktuar nga Komisioni i Posaçëm.
- 7.3.1 Me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe të transparencës në Procedurën Konkurruese, Komisioni i Posaçëm, mund të kërkojë por pa qenë i detyruar, nga Ofertuesit Potencialë që:
- të sqarojnë dokumentet mbështetëse, të bëjnë ndryshime të rregullojnë devijime materiale që mund të rregullohen në mënyrë të arsyeshme brenda Afatit të Korrigjimit duke paraqitur informacion apo dokumentacion shtesë brenda afatit të komunikuar nga Komisioni i Posaçëm, apo;
 - të rregullojnë parregullsitë formale brenda Afatit të Korrigjimit.
- 7.3.2 Autoriteti Kontraktues sipas zgjedhjes së tij mund të ftojë Ofertuesit Potencialë në disa raunde sqarimesh, për informacione shtesë apo rregullime.
- 7.3.3 Gjatë procedurës së Korrigjimit, Autoriteti Kontraktues do të garantojë trajtim të barabartë për të gjithë Ofertuesit Potencialë. Me marrjen e një kërkesë, Autoriteti Kontraktues do tu japë Ofertuesve Potencialë informacion të anonimizuar të kategorive të ndryshmeve apo rregullimeve të lejuara për Ofertuesit. Ky informacion do të jepet në formë të përmbledhur dhe anonimizuar duke mbrojtur në vecanti informacionin konfidencialitetin apo informacionin sensitiv të biznesit. Autoriteti Kontraktues do tu japë Ofertuesve Potencialë në pozita të krahasueshme mundësi të barabarta për të bërë ndryshime, shtesa apo korrigjime.
- 7.3.4 Komisioni i Posaçëm, nuk do të kontaktojë Ofertuesin (t) Potencial(ë) për sqarime apo korrigjime të tjera gjatë fazës së Para-Kualifikimit sipas këtij seksioni nëse vlerëson se Aplikimi i tyre për Kualifikim nuk kualifikohet për shkak të mospërputhjeve apo parregullësive të tjera thelbësore që nuk mund të rregullohen brenda Afatit për Korrigjimet;
- 7.3.5 Komisioni i Posaçëm, nuk do të kontaktojë Ofertuesin (t) Potencial(ë) për kërkesa për sqarime apo rregullime të tjera gjatë fazës së vlerësimit sipas këtij seksioni nëse vlerëson në mënyrë të arsyeshme se Ofertuesi Potencial në mënyrë abuzive apo me neglizhencë të rëndë ka paraqitur një Aplikim për Kualifikim të paplotë.
- 7.3.6 Shembuj për informacione, sqarime shtesë apo korrigjime që Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë gjatë fazës së vlerësimit sipas paragrafit 7.1 më sipër, përfshijnë pa u

kufizuar në sa më poshtë:

- Në lidhje me dëshmitë e duhura për ekperienca të mëparshme, Komisioni i Posaçëm mund të kërkojë sqarime shtesë apo të dhëna të tjera apo dokumentet që mungojnë për referencat që janë bërë për ekperienca të mëparshme në Aplikimin për Kualifikim por nuk do të pranojë informacion që referon tek një experience të re (projekt të ri) që nuk është përfshirë në Aplikimin për Kualifikim e paraqitur në Afatin e Dorëzimit;
- Në lidhje me dëshmitë e duhura për zotërimin e kapaciteteve të duhura teknike Komisioni i Posaçëm mund të kërkojë informacion shtesë nga Ofertuesi Potencial për qëllimin e tij të punës në një experience të caktuar të mëparshme të tij të përfshirë në Aplikimet e tij për Kualifikim apo sqarime të tjera për aftësitë e ekspertëve që ka përfshirë në Aplikimin për Kualifikim. Megjithatë, Komisioni i Posaçëm, gjatë fazës së vlerësimit nuk do të pranojë referime të reja që nuk janë përfshirë në Aplikimin për Kualifikim;
- Në lidhje me dëshmitë e duhura për marrëdhëniet e anëtarëve të Bashkimit të Shoqerive dhe përgjegjësitë apo për ushtrimin e kontrollit mbi një shoqëri tjetër Komisioni i Posaçëm mund të kërkojë vërtetime, deklarata tregtare apo dokumente të tjera të shoqërisë apo dhe kontrata për ato shoqëri apo ndërmarrje që janë përfshirë në Aplikimin për Kualifikim, por nuk mund të pranojë dokumente për shoqëri të tjera të reja që nuk janë përfshirë në Aplikimin për Kualifikim;
- Në lidhje me strukturën organizative, ndryshimet në Bashkimin e Shoqerive apo në marrëveshjet për pjesëmarrje në Bashkimin e Shoqerive, ndryshimet e përgjegjësisë të anëtarëve, ri-pozicionimin e nën-kontaktorit apo të një anëtarit me një rol të ri brenda Bashkimit të Shoqerive të Ofertuesit Potencial apo të strukturës së marrëveshjes së Ofertuesit apo caktimit të një shoqërie apo nën-kontraktori si anëtar i ri i Bashkimit të Shoqerive, nuk do të pranojë hyrjen e një shoqëri të re që nuk ka qenë përfshirë në Aplikimin për Kualifikim ëme përjashtim të rastit të paaftësisë paguese apo falimentimit të shoqërisë (anëtarit) që zëvendësohet.
- Komisioni i Posaçëm mund t'u kërkojë Ofertuesve Potenciale që të rregullojnë disa noterime, legalizime apo përkthime të caktuara të dokumenteve përfshirë Dokumentet e Kualifikimit brenda Afatit për Korrigjimet apo brenda një afati të mëvonshëm që përcaktohet në Shtojcën 4/1.

7.3.7 Parashikimet e mësipërme nuk krijojnë të drejtë ligjore për Ofertuesin Potencial që ky të pretendojë nga Komisioni i Posaçëm t'i kërkojë sqarime apo informacion shtesë. Për hir të qartësisë, Komisioni i Posaçëm ka të drejtë,por jo detyrimin që të ushtrojë kompetencat e tij në paragrafet 7.3.1 deri 7.3.5.

7.4 Komisioni i Posaçëm mund të mos konsiderojë ndonjë mospërputhje apo parregullsi të vogël në një Aplikim për Kualifikim, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht Kriteret e Kualifikimit dhe nuk cenojnë apo paragjykojnë vlerësimin e Aplikimit për Kualifikim në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e KPK .

7.5 Autoriteti Kontraktues ose Komisioni i Posaçëm mund të kërkojë të asistohet nga ose të këshillohet me ekspertë apo institucione të tjera shtetërore (duke përfshirë ata ligjorë, financiar apo teknikë) gjatë procesit të vlerësimit të Aplikimeve për Kualifikim.

Komisioni i Posaçëm do të shqyrtojë çdo sugjerim, vlerësim apo këshillë të dhënë nga ekspertët apo institucionet e tjera shtetërore, si pjesë përkatëse e procesit të vlerësimit të Aplikimit për Kualifikim.

- 7.6 Autoriteti Kontraktues mund të kryejë çdo hetim të arsyeshëm ose procedurë të ngjashme që e gjykon të nevojshme për të shqyrtuar integritetin dhe gjendjen financiare në lidhje me Aplikimin për Kualifikim të një Ofertuesi Potencial, si dhe çdo element tjetër që e gjykon të arsyeshme apo nevojshme.
- 7.7 Ofertuesi Potencial duhet të japë menjëherë informacionin dhe asistencën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e çdo hetimi të nevojshëm.

8 KUALIFIKIMI I OFERTUESVE POTENCIALË DHE APLIKIMET PËR KUALIFIKIM

8.1 Kualifikimi i Ofertuesve Potencialë

Komisioni i Posaçëm do të kryejë një shqyrtim të detajuar të Dokumenteve të Kualifikimit që janë dorëzuar si pjesë e Aplikimit për Kualifikim, në mënyrë që të vendosë nëse Ofertuesi Potencial kualifikohet për fazën e KPP.

8.2 Dokumentet e Kualifikimit

Dokumentet e Kualifikimit përmbajnë të gjithë dokumentet e përcaktuar në Shtojcën 4 dhe 4/1.

8.3 Shqyrtimi i Dokumenteve të Kualifikimit

831 Komisioni i Posaçëm do të shqyrtojë Dokumentet e Kualifikimit të çdo Ofertuesi Potencial (përfshirë informacionin apo dokumentacionin shtesë që janë dhënë në përgjigje të kërkesave për sqarime/rregullime sipas paragrafit 7.3) për të verifikuar nëse janë dorëzuar dhe nëse janë nënshkruar siç duhet të gjitha dokumentet e kërkuara sipas Shtojcës 4 dhe 4/1 (**“Shqyrtimi Paraprak”**).

832 Çdo Dokument i Kualifikimit (përfshirë informacionin apo dokumentacionin shtesë që janë dhënë në përgjigje të kërkesave për sqarime/rregullime sipas paragrafit 7.3.) që konstatohet se nuk përmban të gjitha dokumentet e paraqitura apo nënshkruara siç duhet, sipas Shtojcës 4 dhe 4/1 do të refuzohet nga Komisioni i Posaçëm dhe nuk do të merret parasysh më tej.

833 Komisioni i Posaçëm do të kryejë vlerësimin e detajuar të Dokumenteve të Kualifikimit që nuk janë refuzuar pas Shqyrtimit Paraprak, për të përcaktuar nëse ato përmbushin Kriteret e Kualifikimit. Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni i Posaçëm do të shqyrtojë informacionin dhe dokumentacionin e dorëzuar nga çdo Ofertues Potencial dhe do të mbajë parasysh faktorët e mëposhtëm:

Kriteret e Kualifikimit të përcaktuara në Shtojcën 4 dhe 4/1, do të vlerësohen me “kalon” / “nuk kalon” për çdo kriter.

834 Një Ofertues Potencial, Dokumentet e Kualifikimit të të cilit janë përcaktuar nga Komisioni i Posaçëm se përmbushin Kriteret e Kualifikimit të përcaktuara sipas Shtojcës 4 dhe 4/1, do të përcaktohet si **“Ofertues i Para-Kualifikuar”**.

835 Një Ofertues Potencial, Dokumentet e Kualifikimit të të cilit janë vlerësuar nga Komisioni i Posaçëm se nuk përmbushin Kriteret e Kualifikimit të përcaktuara sipas Shtojcës 4 dhe 4/1, do të përcaktohet si **“Ofertues i Skualifikuar”**.

836 Pas vlerësimit të Dokumenteve të Kualifikimit, Komisioni i Posaçëm:

- do të përcaktojë Ofertuesin Potencial si Ofertues të Skualifikuar dhe do të refuzojë Aplikimin e tij për Kualifikim, me arsyen se ajo nuk përmbush të gjitha Kriteret e

Kualifikimit ose kërkesat e tjera të përcaktuara në Shtojcën 4 dhe 4/1, rast në të cilin Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Ofertuesin e Skualifikuar në përputhje me Shtojcën 8 (*Formulari i Njoftimit të Ofertuesit të Skualifikuar*) ose,

- do të përcaktojë Ofertuesin Potencial si Ofertues të Para-Kualifikuar. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Ofertuesit e Para-Kualifikuar në lidhje me kualifikimin e tyre.

- 837 Ofertuesi i Skualifikuar ka të drejtë që, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga momenti i marrjes së Formularit të Njoftimit të Ofertuesit të Skualifikuar, të paraqesë ankesën e tij pranë Autoritetit Kontraktues në lidhje me mos-kualifikimin e tij, sipas formularit së paraqitur në Shtojcën 10 (*Formulari i Ankesës pranë Autoritetit Kontraktues*)
- 838 Komisioni i Posaçëm do të vijojë më pas me fazën KPP sipas kalendarit dhe do të dërgojë KPP tek Ofertuesit e Para-Kualifikuar.

9 KUFIZIMET

9.1 E drejta për të pezulluar Procedurën e Kualifikimit ose ndërprerë Procedurën e KPK

Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën që, në përputhje me dispozitat ligjore, të pezullojë procedurën konkurruese, qoftë në fazën e KPK apo në fazën e KPP, në mënyrë të përkohshme apo të përhershme, pas çdo vendimi të marrë prej tij në rast riorganizimi të brendshëm ose në çdo situatë tjetër të paparashikuar.

Ofertuesit Potencialë nuk do të kenë asnjë të drejtë të marrin kompensim për humbje të fitimit, për kostot apo shpenzimet në rastin e pezullimit të Procedurës së Kualifikimit apo moszhvillimit të fazës së KPP.

9.2 E drejta për ta deklaruar Procedurën e Kualifikimit “të pasuksesshme”

Autoriteti Kontraktues do ta quajë Procedurën e Kualifikimit të pasuksesshme kur:

- Nuk është dorëzuar asnjë Aplikim për Kualifikim; ose
- Asnjë nga Aplikimet për Kualifikim nuk përmbush kërkesat e KPK.

9.3 E drejta për ta deklaruar Aplikimin për Kualifikim të pavlefshëm

Aplikimi për Kualifikim do të konsiderohet i pavlefshëm nëse:

- Aplikimi për Kualifikim përmban të dhëna të rreme; ose
- Aplikimi për Kualifikim nuk është në përputhje me një ose të gjitha kërkesat e Dokumenteve të Procedurës së Kualifikimit.

10. INFORMACIONE TË MËTEJSHME PËR FAZËN (E 2-TE) E KPP

10.1 Kërkesat në fazën e KPP

Në fazën e KPP, secili Ofertues i Para-kualifikuar do të ftohet të tregojë përshtatshmërinë e vendndodhjes së tij të Propozuar, fizibilitetin teknik, mjedisor dhe social të Projektit të tij dhe të paraqesë Ofertën Financiare. Kriteret teknike, mjedisore dhe sociale do të vlerësohen mbi bazën *kalon / nuk kalon*; më pas Ofertat Financiare (d.m.th. çmimi) do të përdoren për të përzgjedhur Projektet që do të marrin masa mbështetëse. Ofertat financiare që tejkalojnë një çmim tavan prej 75 EUR (shtatëdhjetë e pesë euro) për MW ("**Çmimi Tavan**") nuk do të konsiderohen për përzgjedhje.

Afati i Dorëzimit të KPP për t'iu përgjigjur KPP pritet të të jetë në Shkurt 2023.

Si pjesë e Përgjigjes së tij ndaj KPP, secili Ofertues i Para-Kualifikuar pritet të tregojë përshtatshmërinë e Vendndodhjes së Propozuar nga ai duke dorëzuar dokumentet më poshtë. **Si rrjedhojë, MIE inkurajon Ofertuesit Potencialë që të fillojnë aktivitetet përkatëse sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të të përmbushin detyrimet e tyre brenda Afatit të Dorëzimit të KPP**, në veçanti si më poshtë:

- i. Vërtetim që Vendndodhja e Propozuar nuk ndodhet në zona të përcaktuara sit të "kufizuara" ose "të ndaluara" nga analiza e përgjithshme e erës e territorit shqiptar bashkëlidhur në Shtojcën 15. Ë
 - Ky vërtetim mund të përfshijë por pa u kufizuar në harta kadastrale ose harta të tjera të barazvlershme me koordinata të dukshme qartë për Vendndodhjen e Propozuar⁵.
- ii. Vërtetim që Vendndodhja e Propozuar përmbush kriteret e tjerë, të përcaktuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.06.2018 "*Për miratimin e masave mbështetëse për promovimin e përdorimit të elektricitetit nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe procedurat për përzgjedhjen e projekteve për përfitim të tyre*", i ndryshuar.
 - Çdo Ofertues i Para-Kualifikuar do të dorëzojë hartat kadastrale ose harta të tjera të barazvlershme për të gjitha parcelat e tokës që përbëjnë Vendndodhjen e Propozuar.
- iii. Lejen e zhvillimit të lëshuar nga Autoriteti Kompetent, në përputhje me Ligjin nr.107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar ("**Ligji 107/2014**") dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13 Maj 2015 "*Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit*" i ndryshuar ("**VKM 408**").
 - Leja e zhvillimit përkufizohet nga Ligji 107/2014 si dokument i cili përcakton kushtet e zhvillimit në lidhje me një pronë të caktuar. Leja e zhvillimit shërben si një dokument paraprak për marrjen e lejes së ndërtimit dhe është e vlefshme deri në miratimin e kësaj së fundit.
 - Leja e zhvillimit është e nevojshme për çdo parcelë kadastrale dhe ajo duhet të jepet në përputhje me planin e detajuar rajonal ose planin rajonal (i cili është më pak specifik sesa plani i detajuar rajonal), sipas rastit.

⁵ Sistemi i rekomanduar i koordinatave është sistemi gjeografik ËGS84 ose sistemi i projektuar ËGS 84 / Zona UTM 34N. Sistemet e tjera më të përdorura të koordinatave për Shqipërinë janë të pranueshem me kusht që ato të deklarohen qartë paraprakisht (për të bërë të mundur konvertimin e tyre në ËGS84).

- Aplikimi për lejen e zhvillimit kryhet on-line nëpërmjet portalit e-leje që mund të gjendet në faqen e internetit e-albania.al. Në varësi të vendit ku ndodhet Vendndodhja e Propozuar, leja e zhvillimit mund të lëshohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit, ose kryetari i bashkisë përkatëse.
 - Procedura dhe dokumentet⁶ e kërkuara për pajisjen me leje zhvillimi përcaktohen nga VKM 408. Kohëzgjatja e procedurës për pajisjen me leje zhvillimi mund të jetë midis 25 (njëzet e pesë) deri në 35 (tridhjetë e pesë) Ditë Pune , nga paraqitja e aplikimit. Një periudhë shtesë prej 30 (tridhjetë) Ditësh Pune kërkohet nëse ka nevojë për të kryer një inspektim arkeologjik të zonës ose nëse kërkohet mendimi i institucioneve të trashëgimisë kulturore, ose i institucioneve të tjera publike.
- iv. Ofertën për lidhjen me rrjetin e lëshuar nga OST, në përputhje me Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin Nr.186, datë 11 Nëntor 2017 ("**Kodi i Transmetimit**") të Entit Rregullator të Energjisë dhe me Rregulloren e Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit", miratuar me vendim Nr. 87, datë 20 Prill 2018 të Entit Rregullator të Energjisë, siç mund të ndryshohet herë pas here ("**Rregullorja për Lidhjet e Reja**").
- Në mënyrë që të aplikojë për një ofertë për lidhjen me rrjetin, Ofertuesi i Para-Kualifikuar duhet të paraqesë pranë OST një formular aplikimi, siç përcaktohet në Rregulloren për Lidhjet e Reja, shoqëruar me një sërë dokumentesh ligjore dhe teknike⁷.
 - Pas marrjes së aplikimit, OST kryen një studim mbi pranueshmërinë e aplikimit dhe më pas i paraqet Ofertuesit të Para-Kualifikuar një "ofertë lidhjeje" të cilën ky i fundit mund të zgjedhë ta pranojë duke nënshkruar "deklaratën e pranimi".
 - Vlen për t'u theksuar se oferta për lidhjen me rrjetin, e pranuar në mënyrë të rregullt nga Ofertuesi i Para-Kualifikuar nuk përbën një marrëveshje të lidhjes me rrjetin. OST dhe Ofertuesi i Para-Kualifikuar mund të nënshkruajnë marrëveshjen e lidhjes me rrjetin brenda 18 muajve nga marrja e ofertës për lidhjen me rrjetin nga Ofertuesi i Përzgjedhur.
 - Autoriteti Kontraktues është në kontakt me OST për të siguruar që ky i fundit do të lëshojë një vlerësim të kostos për lidhjen me rrjetin në fazën e ofertës për lidhjen me rrjetin, pa pritur për një marrëveshje përfundimtare për lidhjen me rrjetin.
- v. Studimin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), i hartuar në përputhje me kriteret themelore më të rrepta të legjislacionit shqiptar të zbatueshëm, *acquis*-së mjedisor të Bashkimit

⁶ Lista e dokumenteve që duhet dorëzuar për pajisjen me leje zhvillimi përfshin:

- Formularin e aplikimit;
- Prokurën ose autorizimin përkatës;
- Dokumentacionin që vërteton të drejtat pasurore të zhvilluesit mbi Vendndodhjen e Propozuar dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën;
- Planin e rilevimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar;
- Mandatin për pagesën e tarifës së aplikimit (nëse ka);
- Kopje të licencës së topografit dhe projektuesit;
- Projekt-idenë arkitektonike të zhvillimit, shoqëruar nga një plan që tregon Impiantin në një hartë të rifreskuar, si dhe studimin e fizibilitetit.

⁷ Lista e dokumenteve që duhet dorëzuar për pajisjen me ofertë për lidhjen me rrjetin përfshin:

- Formulari i Aplikimit;
- Të dhëna identifikuese dhe të aktivitetit ekonomik/ligjor (emri i shoqërisë, përfaqësuesi ligjor, adresa, telefoni, faksi, e- mail, web e tjera);
- Të dhëna të rrjetit të përdoruesit, sistemi/objekti që do të lidhet duke përfshirë edhe të dhënat koordinative në hartën e rrjetit elektrik të Sistemit të Transmetimit për pikën/vendin e lidhjes;
- Deklaratë e shkruar mbi gatishmërinë për të zbatuar në mënyrë korrekte dispozitat e Kodit të Transmetimit;
- Studimin e lidhjes së njësive gjeneruesedhe të dhënat sipas planifikimit standart të Kodit të Planifikimit;
- Të dhënat për fazat përkatëse, sipas studimit tekniko-ekonomik të përdoruesit, për realizimin e treguesve të projektit investues (horizontet kohore: fazat e projektimit teknik, fazat e zbatimit, kolaudimi-testimi, komisionimi/marrja në dorëzim dhe energjizimi);
- Listën e dokumentacionit të përgjithshëm dhe teknik që i bashkëlidhet formularit të aplikimit për lidhje të re.

European (BE) dhe standarteve dhe kërkesave mjedisore dhe sociale të huadhënësve/institucioneve financiare ndërkombëtare (IFN) (duke përfshirë të dhëna për zogjtë dhe lakuriqtë e natës për një periudhë të paktën një vjeçare (“**Të Dhëna 1 Vjeçare për Zogjtë dhe Lakuriqtë e natës**”) dhe në përputhje me *Shtojcën 14 (Kushtet e Referencës për një VNMS) (Faza e KPP)*.

- *Acquis* mjedisore e BE-së dhe kriteret mjedisore dhe sociale të aplikuara nga IFN-te përfshijnë, por pa u kufizuar parashikimet përkatëse të Direktivës 2011/92/BE të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) të 31 Dhjetorit 2011, të ndryshuar nga Direktiva 2014/52/BE; Direktiva e Shkarkimeve Industriale 2010/75/BE, Direktivat e Habitave dhe e Shpendëve 2009/147/KE, 93/43/KE; Praktika e Mirë Ndërkombëtare e Industrisë për zhvillimin e centraleve eolike tokësore sipas udhëzimeve të Bankës Botërore (BB) për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë (EHS) mbi Energjinë e Erës (2015) ose standarde të ngjashme; si dhe standardet dhe kërkesat mjedisore dhe sociale të zbatueshme nga kreditorët potencialë siç janë Institucionet Ndërkombëtare Financiare (INF), dhe standardet e zbatueshme nga bankat tregtare që zbatojnë Parimet e Ekuatorit e disponueshme në: <https://ekuator-principles.com>. Për më shumë detaje, ju lutemi referojuni Shtojcës 14 (*Kushtet e Referencës për një VNMS) (Faza KPP)*.
- Të Dhënat 1 Vjeçare për shpendët dhe lakuriqët e natës duhet të mblidhen sipas metodologjive dhe kërkesave të përshkruara në udhëzimet: “Udhëzim- metodat për monitorimin e popullatës së zogjve në parqet eolike tokësore” nga Trashëgimnia Natyrore e Skocisë, dhe “Udhëzimet për marrjen në konsideratë të lakuriqëve të natës në projektet e parqeve eolike” nga Eurobats, e aksesueshme këtu: (https://www.eurobats.org/sites/default/files/documents/publications/publication_series/pubseries_no6_english.pdf).
- Për efekt qartësie, zbatimi i VNMS të sipërmendur kërkon që Ofertuesi i Para-Kualifikuar të bëjë konsultime me publikun e prekur, palët apo komunitetin e interesuar sipas Ligjit të Zbatueshëm, t’u japë atyre akses në informacionin mjedisor përkatës dhe t’i lejojë të bëjnë komente. Kjo nuk do të çenojë të drejtat e palëve të interesuara për të kundërshtuar vendimin e Autoritetit Kontraktues përpara organeve kompetente sipas Ligjit të Zbatueshëm.
- Për efekt qartësie, në këtë fazë nuk kërkohet që Ofertuesi i Para-Kualifikuar të ndjekë procedurat formale për miratimin e studimit të VNMS-së nga huadhënësit potencialë ose autoritet përgjegjës shqiptarë⁸; kërkohet vetëm përgatitja e një studimi VNMS që përmbush standartet themelore mjedisore dhe sociale.⁹ Brenda 6 (gjashtë) muajve pas marrjes së vendimit të dhënies së KPP-së për Ofertuesin (it) e Përzgjedhur, periudhë e cila mund të zgjatet me kohëzgjatjen e një ngjarjeje të Forcë Madhore ose të Aktit të Pavaforshëm Qeveritar ose sikurse kërkohet nga autoritetet kompetente shqiptare¹⁰ dhe duke u bazuar në studimin thelbësor të VNMS-së të paraqitur si pjesë e Propozimit e KPP, Ofertuesi (et) e Zgjedhur duhet të plotësojnë procedurat zyrtare për lëshimin e lejes mjedisore sipas ligjit shqiptar dhe për marrjen e miratimit zyrtar të VNMS nga huadhënësit e mundshëm. Për më shumë detaje, ju lutemi referojuni Shtojcës 14 (*Kushtet e Referencës për një VNMS) (Faza KPP)*.

⁸ Ofertuesi (et) i(e) Përzgjedhur duhet të përfundojnë procedurat për marrjen e lejes mjedisore sipas ligjit dhe për marrjen e miratimit zyrtar të VNMS nga kreditorët e mundshëm duke u bazuar në studimin e VNMS-së të paraqitur si pjesë e propozimeve në KPP brenda 6 (gjashtë) muajve nga shpallja e tenderit.

⁹ Siç listohen më sipër në referencën 1 dhe 2.

¹⁰ Kushtet e detajuara të Forcës Madhore ose të Aktit Material të Pavaforshëm Qeveritar do të publikohen më vonë në fazën e KPP.

- vi. Raportin e prodhimit të energjisë (bazuar në matjet e erës në vendndodhje për të paktën një vit) siç kërkohet nga praktika e mirë e industrisë.
- Për fushatën e matjeve duhet:
 - përdorimi i anemometrit të kalibruar me cilësi të lartë (mundësisht anemometër i Klasit I), sa më afër lartësisë maksimale së shtyllës (mundësisht $> 2/3$ e lartësisë së shtyllë). Instalimi i anemometrave, të kryhet mundësisht në tre lartësi, në mënyrë që ekstrapolimi vertikal të kryhet me saktësi.
 - përdorimi i anemometrave rezervë për të minimizuar mundësinë e humbjes së të dhënave për shkak të vendosjes së kullës ose dështimit të sensorit. Përdorni krahë të gjatë për të minimizuar ndikimin e shtrembërimit të rrymës së erës.
 - vendosja e dy ose më shumë shtyllave matëse në një vendndodhje të parkut eolik, mundësisht një shtyllë matëse për çdo 5-8 turbina ose kapacitet 10-20 MW (numri është për një terren kompleks përdoret një numër më i ulët dhe për një terren normal përdoret një numër më i lartë).
 - mbledhje dhe analizim rigoroz i të dhënave ditore. Sigurohuni që të dhënat e papërpunuara të arkivohen dhe të ketë një gjurmë auditimi për korrigjimet e të dhënave, në mënyrë që të dhënat të verifikohen në mënyrë të pavarur.
 - Prodhimi Vjetor i Energjisë (PVE) duhet të marrë parasysh aspektet e mëposhtme:
 - PVE do të bazohet në një model linear të rrymës së erës për një terren të thjeshtë ose një model komputacional së dinamikës së lëngjeve (CFD) për një terren kompleks.
 - Korrigjimi afatgjatë i PVE duhet të programohet për të llogaritur variacionet vjetore të klimës së erës.
 - Vlerësimi i humbjeve dhe panjohurisë së vendndodhjes specifike. Vlerësimi i shpejtësisë ekstreme të erës për të zgjedhur një kategori të përshtatshme të turbinave për vendndodhjen.
- vii. Dokumentacionin që vërteton se ofertuesi potencial gëzon të drejtën e pronësisë ose të drejta reale për posedimin dhe gëzimin e vendndodhjes së propozuar, me qëllim projektimin, ndërtimin, instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e projektit, të dorëzuar në përputhje me formën e duhur për marrjen e lejes së ndërtimit dhe të regjistruar në mënyrë të rregullt në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.
- Për hir të qartësisë, lëshimi zyrtar i lejes së ndërtimit nuk është e nevojshme në fazën e KPP-së; duhet të merret nga Ofertuesi i Përzgjedhur pas shpalljes së Ofertuesit të Përzgjedhur.
 - Vërtetimi i titullit të pronësisë ose e të drejtave të përdorimit, përfshin por pa u kufizuar në certifikatën e pronësisë, kontratën e shitblerjes për transferimin e titullit të pronësisë mbi vendodhjen, ose transferimit të së drejtës për përdorimin dhe gëzimin e vendodhjes, kontrata qiraje, emfiteoze ose kontratë uzufukti, leje për përdorimin e vendodhjes publike, të lëshuar nga autoriteti publik kompetent ose bashkia.
 - Pavarësisht procedurave për pajisjen me të gjithë të drejtat e pronësisë mbi sendin, zhvilluesi në çdo rast duhet të veprojë në përputhje me kriteret e Aplikueshme të VNMS që jepen në Shtojcën 14 përfshirë përgatitjen e në Planin e Rregullimi të vendndodhjes së propozuar, linjës së transmetimit dhe të çdo strukture tjetër mbështetëse.
- viii. Dokumentacion që vërteton disponueshmërinë e tokës për të drejtën e kalimit që kërkohet për ndërtimin dhe operimin e linjës së transmetimit për lidhjen e Projektit në rrjet, me miratimin e

OST dhe sipas ligjeve në fuqi; Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, dhe Ligji Nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

- Ofertuesi i Para-Kualifikuar duhet të identifikojë parcelën e tokës (qoftë private apo publike) mbi të cilën do të ndërtojë linjën e transmetimit. Ofertuesi i Para-Kualifikuar duhet të paraqesë marrëveshjet/kontratat apo deklaratat që ka lidhur "në parim" me pronarët apo përdoruesit e parcelës përkatëse të tokës që provojnë se Ofertuesi i Para-Kualifikuar gëzon të drejtën e kalimit në parcelat e tokës për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës së transmetimit.
- Pavarësisht procesit për blerjen e të drejtave të nevojshme mbi tokën apo pasurinë, zhvilluesi në çdo rast duhet të veprojë në përputhje me kriteret e aplikueshme të VNMS që jepen në Shtojcën 14 përfshirë përgatitjen e një Plani Rregullimi të vendndodhjes së propozuar, linjës së transmetimit dhe të çdo strukture tjetër mbështetëse

ix. Deklaratë detyruese e lëshuar nga Ofertuesi i Para-Kualifikuar që vërteton përputhshmërinë e pajisjeve dhe të projektimit, ndërtimit, kolaudimit dhe operimit të projektit me standardet ndërkombëtare dhe specifikimet teknike.

- Duhet të zbatohen të gjitha standardet e zbatueshme ndërkombëtare dhe vendase. Lista e mëposhtme e standardeve minimale përkatëse do të konsiderohet si një referencë jo shterruese:
 - IEC 61400-01 Kërkesa për projektim;
 - IEC 61400-04 Kërkesat për projektimin e kutive të shpejtësisë së turbinave me erë;
 - IEC 61400-05 Fletët e Turbinës Eolike;
 - IEC 61400-06 Dizajni i kullës dhe bazës;
 - IEC 61400-07 Siguria e inverterave të turbinave të erës;
 - IEC 61400-11 Teknikat e matjes së zhurmës akustike;
 - IEC 61400-12-1 Matjet e performancës së energjisë;
 - IEC 61400-12-2 Performanca e energjisë bazuar në shportën e anemometrit;
 - IEC 61400-12-3 Testimi i performancës së energjisë në Parkun Eolik;
 - IEC 61400-12-4 Verifikimi i performancës së energjisë së turbinave me erë që prodhojnë energji elektrike bazuar në kalibrimin numerik të vendndodhjes;
 - IEC 61400-13 Matja e ngarkesave mekanike;
 - IEC 61400-14 Deklarata e e nivelit të fuqisë dhe tonalitetit të tingullit;
 - IEC 61400-15 Vlerësimi i kushteve specifike të erës në vendndodhje për stacionet e energjisë së erës;
 - IEC 61400-21 Matja dhe vlerësimi i karakteristikave të cilësisë së energjisë së turbinës së erës të lidhur në rrjet;
 - IEC 61400-22 Testimi i përputhshërisë dhe Certifikimi i turbinave eolike;
 - IEC 61400-23 Testim strukturor i plotë i fletëve të rotorit;
 - IEC 61400-24 TR Mbrojtja nga rrufetë;
 - IEC 61400-25 Komunikimi për monitorimin dhe kontrollin e centraleve;
 - IEC 61400-26-1: Disponueshmëria kohore për turbinat eolike;
 - IEC 61400-26-2: Disponueshmëria e bazuar në prodhim për turbinat eolike;
 - IEC 61400-27-1 Modele të simulimit elektrik për gjenerimin e turbinave eolike;
 - IEC 61400-27-2 Modele të simulimit elektrik për gjenerimin e centraleve eolike;
 - IEC 61400-30 Siguria e GPT-ve Parimet e Përgjithshme të Projektimit;
 - IEC 61400-40 Përputhshmëria Elektromagnetike (EMC),
 - IEC 61400-415 Terminologjia.

x. Studimi Paraprak i Fizibilitetit përfshin:

(a) Aspektet Teknike

- Përshkrim i përgjithshëm i Vendndodhjes

- Vlerësim i resurseve të erës (d.m.th. specifikimet e stacioneve anemometrike, matjet e erës së papërpunuar, studimi anemometrik, paraqitja e turbinave prove, etj.)
- Analiza teknike e kufizimeve (d.m.th. rrugët e hyrjes, analiza e shpateve të vendit, afërsia me nënstacionet e energjisë, etj.)
- Të dhëna për pajisjet e propozuara ËTG

(b) Aspektet mjedisore dhe sociale

- VNMS (siç specifikohet më sipër)

(c) Aspektet financiare

- Një plan financiar që demonstroi qëndrueshmërinë financiare të Projektit të propozuar. Analiza financiare pritet të tregojë flukse vjetore parash për çdo vit gjatë gjithë jetës së projektit, duke përfshirë:
 - Rendimenti i energjisë
 - Të ardhurat nga energjia
 - Kostot e kapitalit
 - Kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes
 - Marrëveshjet e financimit
 - Tarifat e kthimit

xi. Dëshmi të besueshme dhe të verifikueshëm financimi për të mbuluar vlerën totale të investimit të propozuar të Projektit në një nga këto forma:

- (a) Letra e mbështetjes "në parim" e lëshuar nga institucioni (et) financues (e) me një vlerësim kreditor minimal prej A3 nga Moody's (ose ekuivalente); ose
- (b) Autorizimi nga Bordi i kompanisë, ose autoriteti më i lartë vendimmarrës i Ofertuesit të Para-Kualifikuar, për të siguruar fonde nga burime të brendshme; ose
- (c) Një kombinim i formave (a) dhe (b) më sipër.

10.2 Tenderat e Ardhshme Eolik

Kjo Procedurë konkurruese është e para e një serie tenderash të planifikuara për projektet eolike. Projektet që rezultojnë të pasuksesshme në Tenderin e parë mund të marrin pjesë në procedurat e ardhshme konkurruese për përfitimin e mbështetjes për projektet eolike. Autoriteti Kontraktues do të publikojë në momentin e duhur të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kohën dhe kapacitetet e procedurave të ardhshme konkurruese. Gjithashtu në procedurat e ardhshme do të rishikohen kufizimet për madhësinë individuale të projektit dhe kufizimet për vendndodhjet e propozuara.

SHTOJCA 1
LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL
[Shtojcë për t'u plotësuar nga Ofertuesi Potencial]
 (Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqeve dhe pikat në dokumentet e tenderit që dëshironi të mbeten konfidencial	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor gjatë së cilit ky informacion duhet të mbetet konfidencial

SHTOJCA 2

FORMULARI I DEKLARIMIT TË APLIKIMIT PËR KUALIFIKIM

Marrësi: Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë e Republikës së Shqipërisë

Procedura: Me Dy Faza me mundësi për negociim

Përshkrim i shkurtër i Projektit: Projektimi, financimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e Impiantit Tokësor Eolik e me kapacitet të instaluar ndërmjet 10 MW dhe 75 MW (përfshirë), si pjesë e masave mbështetëse për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga ky kapacitet, me vendndodhjen e caktuar nga Ofertuesi brenda Republikës së Shqipërisë (“**Procedura**”).

Duke iu referuar Procedurës Konkurruese të lartpërmendur, ne, të nënshkruarit [•], në cilësinë e [•], deklarojmë se:

- A. pasi kemi shqyrtuar Dokumentet e KPK, pranojmë pa rezerva kërkesat, afatet dhe kushtet e përcaktuara në Dokumentet e KPK;
- B. përmbushim të gjitha kërkesat ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike të Dokumenteve të KPK;
- C. Aplikimi për Kualifikim jonë është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese dhe është detyruese për ne nëse ne do të përzgjidhemi si Ofertues dhe vendosim që të marrim pjesë në fazën e KPP sipas kritereve të KPP.
- D. nuk do të marrim pjesë si Ofertues në më shumë se një Ofertë në këtë Projekt;
- E. autorizojmë Autoritetin Kontraktues të verifikojë informacionin dhe dokumentet bashkëngjitur kësaj Oferte;
- F. ne kuptojmë se MIE mund të anulojë Procedurën e Konkurrimit në çdo kohë dhe MIE nuk ka detyrim ligjor të pranojë Ofertën që merr dhe se MIE fton Ofertuesit të ofertojnë për Projektin, pa shkaktuar detyrime për Ofertuesit, në përputhje me seksionin 12 të Dokumenteve të KPK. Pranojmë dhe kuptojmë se Aplikimi për Kualifikim është objekt i parashikimeve të Dokumenteve të KPK. Ne nuk do të kemi në asnjë rast, asnjë pretendim apo të drejtë të asnjë lloji natyre, në rast se nuk shpallemi fitues i Projektit.

Data e Deklaratës:[•]

Ofertuesi, ose Anëtari Kryesues i Bashkimit të

Shoqërive: [•]

SHTOJCA 3
DEKLARATË MBI KONFLIKTIN E INTERESIT
(për tu plotësuar nga Ofertues Potenciali, ose çdo anëtar
i Bashkimit të Shoqërive)

Për: [Emri i Autoritetit Kontraktues]

Ne, [Emri i Ofertuesit Potencial] po marrim pjesë në Procedurën Konkurruese që do të zhvillohet më datë [•], e shpallur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthorta që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe të përgjegjësisë.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Paragrafi II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë publike janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zv/kryeministri, ministrat, ose zv/ministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barasvlershëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhore, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik deklaroj nën përgjegjësinë time personale:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Paragrafi II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

SHTOJCA 4

KRITERET E KUALIFIKIMIT

Dokumentet e Kualifikimit do të përmbajnë dokumentet e mëposhtme:

- (a) Pjesa I – Dokumentat e kërkuara nga Paragrafi 1.1.1 këtu më poshtë;
- (b) Pjesa II – Informacionin e kërkuar nga Paragrafi 1.1.2 këtu më poshtë;
- (c) Pjesa III – kur Ofertuesi Potencial është një Bashkim Shoqërisë, dokumentet e kërkuara nga Paragrafi 1.1.3 këtu më poshtë;
- (d) Pjesa IV – prokura e kërkuar nga Paragrafi 1.1.4;
- (e) Pjesa V – Literatura ekzistuese e lidhur në mënyrë të veçantë opsionale siç përcaktohet në Paragrafin 1.1.5; dhe
- (f) Pjesa VI – Deklarata e përputhshmërisë së teknologjisë së propozuar dhe respektimi i standarteve ndërkombëtare

Kërkesat për Noterimet, Legalizimet dhe Përkthimet

- Të gjitha dokumentat që janë pjesë e Dokumenteve të Kualifikimit, duhet të dorëzohen origjinale ose si kopje të vërtetuara nga një noter publik.
- Të gjitha dokumentat që janë pjesë e Dokumenteve të Kualifikimit, e që janë lëshuar nga autoritetet publike e shtetërore jo Shqiptare, duhet të dorëzohen gjithashtu të legalizuara në përputhje me kërkesat për Legalizimin dhe Apostilën të Ligjit të Zbatueshëm dhe të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë.
- Dokumentat e noteruara apo të vërtetuara nga një noter jashtë territorit të Shqipërisë, duhet gjithashtu të legalizohen apo të mbajnë vulën apostile në përputhje me kërkesat për Legalizimin dhe Apostilën të Ligjit të Zbatueshëm dhe të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë.
- Ofertuesit Potencialë nëpërmjet një njoftimi me shkrim të nënshkruar rregullisht të përfshirë në Oferten e tyre mund të kërkojnë që të paraqesin origjinalin, kopjet e vërtetuara, të legalizuara të Dokumenteve të Kualifikimit pas Afatit të Dorëzimit të Aplikimit për Kualifikim por jo më vonë se Afati për Rregullimet që përcaktohet në paragrafin 7.3 të Dokumenteve të KPK.
- Dokumentet në gjuhë të huaj (jo-Shqip) duhet të shoqërohen me përkthimin e tyre në shqip të vërtetuar nga një noter publik dhe të legalizohen apo të apostilohen në përputhje me kërkesat për Legalizimin dhe Apostilën të Ligjit të Zbatueshëm dhe të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë.
- Për dokumentet në gjuhën angleze, Ofertuesit Potencialë mund të paraqesin përkthimin e tyre në shqip të vërtetuar dhe të legalizuar pas Afatit të Dorëzimit të Aplikimit për Kualifikim por jo më vonë se Afati për Rregullimet që përcaktohet në paragrafin 7.3 të Dokumenteve të KPK.
- Për dokumentet e paraqitura në gjuhën angleze dhe të vërtetuara e të legalizuara në formën e caktuar, Autoriteti Kontraktues mund të heqë dorë nga kërkesa paraqitjen e përkthimit të tyre në shqip para shpalljes së vendimit të tij me kusht që Ofertuesi (t) Potencial të lëshojë një

deklaratë me fuqi detyruese sipas kërkesës së Autoriteti Kontraktues ku të deklarojë se do të paraqesë përkthimin në shqip brenda afatit që do të caktojë Autoriteti Kontraktues.

- Autoriteti Kontraktues ka të drejtë (por nuk ka detyrimin) t'i kërkojë Ofertuesve Potencialë rregullimin e vërtetimit, legalizimit dhe/apo përkthimit të të gjithë dokumenteve që janë pjesë e Dokumenteve të Kualifikimit, gjatë fazës së vlerësimit sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 7.3 të Rregullave të KPK.

1.1.1 Pjesa I – Kriteret e Para-Kualifikimit

Në Pjesën I të kriterëve të para-kualifikimit, secili Ofertues Potencial, ose secili anëtar i një Bashkimi të Shoqërive ofertuese do të ofrojnë si më poshtë:

(a) Dokumentet ligjore dhe informacionin e mëposhtëm:

- i. Ekstrakt të lëshuar nga regjistri tregtar, gjykata që ka kompetencë për çështje tregtare ose çdo autoritet tjetër kompetent publik në juridiksionin e Ofertuesit Potencial, që provon regjistrimin e Ofertuesit Potencial si person juridik;
- ii. Certifikatë lëshuar nga një autoritet kompetent publik në juridiksionin e Ofertuesit Potencial, që konfirmon se Ofertuesi Potencial nuk është në proces falimentimi ose likuidimi;
- iii. Vërtetim lëshuar nga një autoritet kompetent në juridiksionin e Ofertuesit Potencial, që vërteton se Ofertuesi Potencial nuk është dënuar për vepër penale;
- iv. Vërtetim lëshuar nga një autoritet kompetent në juridiksionin e Ofertuesit, që vërteton se Ofertuesi nuk është dënuar në lidhje me aktivitetin e tij profesional;
- v. Vërtetim lëshuar nga një autoritet kompetent në juridiksionin e Ofertuesit Potencial që vërteton se kapitalet dhe asetet e Ofertuesit Potencial nuk janë objekt i një urdhri përmbarimor;
- vi. Vërtetim lëshuar nga një autoritet kompetent në juridiksionin e Ofertuesit Potencial që vërteton se Ofertuesi Potencial nuk është në ndjekje penale;
- vii. Vërtetim lëshuar nga një autoritet kompetent në juridiksionin e Ofertuesit Potencial (psh. Autoritet tatimor), që vërteton se Ofertuesi Potencial nuk ka detyrime tatimore ose detyrime të sigurimeve shoqërore të papaguara;
- viii. Dokument që vërteton strukturën e pronësisë dhe të drejtat e administrimit të Ofertuesit Potencial.

Nëse vërtetimet/certifikatat e listuara ii-vii nuk mund të lëshohen në juridiksionin ku Ofertuesi Potencial ka vendin e tij të regjistrimit ose vendin kryesor për ushtrimin e aktivitetit, do të mjaftojë për Ofertuesin që të nënshkruajë një Vetëdeklaratë në formën e Shtojcës 6 sipas udhëzimeve të KPK. Ofertuesit Potencial që kanë vendin e tyre të regjistrimit në Shqipëri mund të nënshkruajnë një Deklaratë që nuk kanë Dënime Penale, në formën e Shtojcës 5 bashkëngjitur këtyre Dokumentave të KPK për të plotësuar kërkesat e parashikuara në nën-paragrafët iii) dhe vi) më sipër.

- ix. Ofertuesi Potencial nuk duhet të jetë i listuar si shoqëri që nuk mund të kryejë aktivitet tregtar në Shqipëri ose në shtetet e BE dhe nuk duhet të jetë në listën e zezë në listën e Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFI).
- x. Ofertuesi Potencial nuk duhet të jetë në ndonjë listë të Kombeve të Bashkuara të personave të përfshirë në aktivitete terroriste ose ndonjë listë tjetërtë zezë kombëtare ose ndërkombëtare.
- xi. Ofertuesi Potencial dhe çdo aksionar në zinxhirin e tij të pronësisë, duke përfshirë përfituesin fundor, ose secilin prej degëve / filialeve ose drejtorëve, nuk duhet të ndodhen, kryejnë aktivitet, tregtojnë ose të kenë lidhje me shtetet që u është vendosur embargo nga OFAC ose objekt të sanksioneve të BE ose Kombeve të Bashkuara ose është në një shtet që është në listën e zezë të BE-së.
- xii. Një deklaratë me shkrim nga Ofertuesi Potencial (ose një deklaratë me shkrim nga secili prej anëtarëve të Bashkimit të Shoqërive) siç detajohet në Shtojcën 3 (*Formulari i Deklaratës mbi Konfliktin e Interesit*) mbi konfliktin e interesit; në rast se Ofertuesi Potencial është një Bashkim Shoqërish, Shtojca 3 (*Formulari i Deklaratës mbi Konfliktin e Interesit*) duhet të nënshkruhet gjithashtu nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Bashkimit të Shoqërive;
- xiii. Informacion kryesor mbi Ofertuesin Potencial (ose secilin anëtar të Bashkimit të Shoqërive) siç detajohet në Shtojcën 12 (*Informacioni mbi shoqërinë e Ofertuesit*), duke përfshirë një listë të përditësuar të aksionarëve dhe informacion mbi përfituesit fundorë të Ofertuesit Potencial, psh. person/a fizik/ë që zotërojnë ose ushtrojnë kontroll ndaj një shoqërie (SPV) dhe/ose persona fizikë në emër të cilëve po bëhet transaksioni ose projekti dhe/ose ato persona që ushtrojnë kontroll fundor efektiv mbi një person juridik ose marrëveshje, kanë interes ekonomik thelbësor ose marrin përfitim ekonomik thelbësor nga një shoqëri.

Këto duhet të përfshijnë në veçanti individë që plotësojnë një ose më shumë nga pesë kushtet e mëposhtme:

- zotëron direkt ose indirekt më shumë se 10% të aksioneve të Ofertuesit Potencial;
- zotëron direkt ose indirekt më shumë se 10% të drejtave të votës të Ofertuesit Potencial;
- zotëron direkt ose indirekt të drejtën për të emëruar apo larguar shumicën e drejtorëve të Ofertuesit Potencial;
- ka të drejtë të ushtrojë, ose ushtron aktualisht, influencë ose kontroll influencues mbi Ofertuesin Potencial; dhe/ose
- atëherë ku një fond ose firmë do të përmbushte një nga katër kushtet e para nëse do të ishte një individ, çdo individ që zotëron të drejtën për të ushtruar ose aktualisht ushtron influencë ose kontroll të rëndësishëm mbi veprimtarinë e atij fondi ose firme.

Informacioni për secilin përfitues duhet të përfshijë:

- emrin e plotë aktual ose çdo emër të mëparshëm;
- kombësinë dhe numrin e identitetit kombëtar;
- vendbanimi;
- datën dhe vendin e lindjes;
- nivelin e pronësisë së përfituesit; dhe
- detaje si ushtrohet pronësia, kontrolli ose interesi ekonomik ushtrohet. Nëse këto detaje janë dorëzuar në një regjistrë qendror të përfituesit, aplikimi mund të përmbushë këtë kërkesë nëpërmjet ndër-referimit dhe bashkëlidhjes së këtij dokumenti. Secili anëtar i një Bashkimi Shoqërisht duhet të publikojë informacionin mbi pronësinë e përfituesit. Një Ofertues Potencial do të njoftojë me shkrim Komisionin e Posaçëm, sa më shpejt të jetë arsyeshëm praktike, për çdo ndryshim material, duke përfshirë ndryshimet në pronësinë e përfituesit nga ajo e raportuar në fillim.

(b) Një Formular i Deklarimit të Aplikimit për Kualifikim në formën e Shtojcës 2 (*Formulari i Deklarimit të Aplikimit për Kualifikim*), që përfshin, ndër të tjera, një deklaratë që konfirmon se ato pranojnë kushtet e Dokumenteve të KPK (të ndryshuar në përputhje me Dokumentat e KPK, nëse është e zbatueshme) siç është hartuar. Nëse Ofertuesi Potencial është një Bashkim Shoqërisht, Shtojca 2 (*Formulari i Deklarimit të Aplikimit për Kualifikim*) duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i secilit anëtar të Bashkimit të Shoqërive.

Certifikatat dhe ekstraktet e kërkuara sipas këtij seksioni, duhet të jenë të përditësuara dhe të mos jenë lëshuar më herët se 90 ditë kalendarike para Afatit të Dorëzimit.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i kërkojë Ofertuesve Potencialë të paraqesin versione të përditësuara të ekstrakteve, certifikatave apo të dokumenteve të shoqërisë sipas këtij seksioni gjatë fazës së vlerësimit sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 7.3 të Dokumenteve të KPK dhe më vonë në fazën e KPP sipas kërkesave të paketës së KPP.

1.1.2 Pjesa II – Kriteret e Kualifikimit

Në Pjesën II të Dokumenteve të Kualifikimit, Ofertuesi Potencial duhet të japë prova se ai përmbush Kriteret e Kualifikimit të përcaktuara në Shtojcën 4/1 (*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*).

1.1.2.1 Njohja e eksperiencës në lidhje me një grup shoqërisht

Një Ofertues Potencial, në lidhje me Kriteret e Kualifikimit KK1 dhe KK2 të Shtojcës 4/1, mund të dorëzojë informacionin dhe dokumentat përkatëse të Shoqërive të Grupit të Ofertuesit

që provojnë gjithësesi se Shoqëria/të e Grupit të Ofertuesit Potencialpërbush/in Kriteret e Kualifikimit KK1 dhe KK2 të Shtojcës 4/1. “Shoqëritë e Grupit të Ofertuesit”, konsiderohen çdo entitet që Kontrolllohet direkt ose indirekt nga Ofertuesi. Përkufizimi “**Kontroll**” do t’i referohet kompetencës për të ushtruar kontroll influencues mbi një ndërmarrje, person fizik apo juridik përmes zotërimit të shumicës së votave apo të drejtave të votës, me kontratë apo ndryshe, qoftë veçmas apo bashkërisht sipas rrethanave faktike e ligjit përkatës.

Nëse një Ofertues Potencial do të përdorë kredencialet e Shoqërive të Grupit të Ofertuesit Potencial, ashtu sic specifikohet në paragrafin më sipër, atëherë, Ofertuesi Potencial është i detyruar të paraqesë për Shoqëritë e Grupit të Ofertuesit Potencial, të gjitha dokumentat e listuara në 1.1.1. Pjesa 1 – Kriteret e Parakualifikimit pika (a) në këtë Shtojcë.

Gjithashtu, Ofertuesi Potencial do të paraqesë evidenca ligjore të certifikuara, mbi lidhjen e tij me Shoqëritë e Grupit të Ofertuesit Potencial, duke evidentuar pronësinë dhe Kontrollin.

1.1.3 Pjesa III - Dokumentet dhe Kërkesat për Bashkimin e Shoqërive

Një Ofertues Potencial që dëshiron të kualifikohet si një Bashkim Shoqërish do të dorëzojë si Pjesa III e Dokumentave të Kualifikimit, dokumentat e mëposhtme:

(a) Prokurë, të noterizuar rregullisht që provon emërimin e personit që autorizohet rregullisht nga të gjithë anëtarët e Bashkimit të Shoqërive për të vepruar në emër të tyre;

(b) Marrëveshjen e Bashkimit të Shoqërive, të noterizuar, që do të lidhet dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjorë të anëtarëve të tyre, e cila, ndër të tjera, konfirmon angazhimin dhe interesin e secilit anëtar në Bashkimin e Shoqërive, e cila duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Për një anëtar Bashkim Shoqërish që të kontribuojë në përbushjen e Kritereve Teknike dhe Financiare, duhet të zotërojë minimalisht 20 % të Bashkimit të Shoqërive;
- Afat minimal për të qëndruar (Kycja) në shoqërinë SPV, për anëtarin e Bashkimit të Shoqërive që kontribuon në përbushjen e Kritereve Teknike dhe Financiare - prej 3 vjetësh nga Data e Fillimi të Operimit (COD), gjatë së cilës këta anëtarë nuk mund të largohen nga roli i tyre në Bashkimin e Shoqërive. Kjo në veçanti do të sigurojë kohën e duhur për Anëtarin Teknik për transferimin e njohurive të tij tek anëtarët e tjerë (p.sh. vendasit). Pas mbarimit të afatit për të qëndruar në SPV, këta anëtarë do të kishin të drejtë të dilnin nga SPV-ja në përputhje me kushtet e MZHPë. Nëse ata dalin më parë, autoritetet shqiptare do të kishin të drejtë të skualifikojnë ose të përfundojnë PDA duke kërkuar rrjedhimisht kompensim;
- Përgjegjësia e përbashkët e anëtarëve të Bashkimit të Shoqërive – në përputhje me

Marrëveshjen e Bashkimit të Shoqërive, të gjithë anëtarët do të ishin bashkarisht përgjegjës nga nënshkrimi i Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit deri në regjistrimin e SPV-së. Me regjistrimin e SPV-së, pavarësisht se përgjegjësia i kalon SPV-së, të gjithë anëtarët do të mbeteshin bashkarisht përgjegjës me SPV-në të paktën deri në COD (Data e Fillimit të Operimit);

- Anëtarët e Bashkimit të Shoqërive do të duhet të identifikojnë qartësisht përqindjet e pjesëmarrjes së secilit anëtar në Bashkimin e Shoqërive dhe rrjedhimisht pjesëmarrjen në SPV;
- Anëtarët e Bashkimit të Shoqërive duhet të identifikojnë dhe të zgjedhin Anëtarin Kryesues të Bashkimit të Shoqërive, i cili do të autorizohet në mënyrë të parevokueshme për të përfaqësuar të gjithë anëtarët e Bashkimit të Shoqërive në Procedurën Konkurruese;
- Marrëveshja e Bashkimit të Shoqërive duhet të përcaktojë qartësisht kontributet e detajuara, fushën e punës dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej anëtarëve të Bashkimit të Shoqërive në Projekt.

1.1.4 Pjesa IV –Prokura

Çdo Ofertues Potencial (ose nëse Ofertuesi është një Bashkim Shoqërorish, secili anëtar) duhet të dorëzojë në Pjesën IV të Dokumenteve të Kualifikimit, një prokurë të shkruar, në formën e Shtojcës 11, të noterizuar rregullisht, ku të cilësohet se personi(at) që ka nënshkruar Ofertën ka(në) kompetencat për të nënshkruar.

1.1.5 Pjesa V – Literatura ekzistuese

Nëse Ofertuesi Potencial dëshiron të dorëzojë literaturë ekzistuese (p.sh. broshura) për Ofertuesin Potencial ose anëtarët e Bashkimit të Shoqërive, kjo literaturë duhet të përfshihet në Pjesën V të Dokumenteve Kualifikuese dhe do të paraqitet veçmas. Literatura ekzistuese mund të dorëzohet në Anglisht apo në Shqip. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'u kërkojë Ofertuesve Potencial versionin e përkthyer në Shqip në formën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në afatin e caktuar prej tij sipas paragrafit 7.3 .

SHTOJCA 4/1
KRITERE SPECIFIKE KUALIFIKIMI

Kriteret e Kualifikimit – Teknike Këto kritere vlerësohen me formulën Kalon/ Nuk kalon.	Dokumentet e Kërkuara / Forma Dokumentet mbështetëse që provojnë aftësitë e Ofertuesit Potencial. Anëtari i bashkimit të shoqërive që kontribon në plotësimin e Kriterit Teknik dhe Financiar, duhet të zotërojë një pjesëmarrje minimumi prej 20% në Bashkimin e shoqërive.
KK1: Kriteri Teknik 1 – Eksperienca e Mëparshme 1 Eksperienca në zhvillimin dhe operimin e një impianti për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme (erë, dielli, uji, biomasa etj.) që përfshin të paktën tre impiante me kapacitet total 30 MW apo më shumë, që provohet me paraqitjen e certifikatave të komisionimit, apo dokumenteve të tjera të ngjashme, në 10 vitet e fundit.	DKK1: • Certifikata të vlefshme të komisionimit apo dokumente të tjera të ngjashme. • Formulari A2, sipas kësaj Shtojce • Çdo kriter për eksperiencën duhet të plotësohet (të paktën) nga një anëtar i Bashkimit i shoqërive (që duhet të plotësojë kriterin minimal të pjesëmarrjes).
KK 2: Kriteri Teknik 2 – Eksperienca e Mëparshme 2 Eksperienca në zhvillimin dhe operimin e një impianti fotovoltai me panele diellore (PV) për prodhimin e energjisë që përfshin të paktën një impiant me kapacitet 20MWp apo më shumë, që provohet me paraqitjen e certifikatave të komisionimit apo dokumenteve të tjera të ngjashme në 5 vitet e fundit.	DKK2: • Certifikata të vlefshme të komisionimit apo dokumente të tjera të ngjashme • Formulari A2, sipas kësaj Shtojce • Çdo kriter për eksperiencën duhet të plotësohet (të paktën) nga një anëtar i Bashkimit të Shoqërive (që duhet të plotësojë kriterin minimal të pjesëmarrjes).

Kriteret Kualifikuese – Ekonomike Këto kritere vlerësohen me formulën Kalon/ Nuk kalon.	Dokumentet e Kërkuara / Formularët Dokumentet mbështetëse që provojnë kapacitetin e Ofertuesit Potencial. Anëtari i bashkimit të shoqërive që kontribon për plotësimin e Kriterit Teknik dhe Financiar, duhet të zotërojë një pjesëmarrje minimumi 20% në Bashkimin e shoqërive.
--	--

KK3: Kriteri Ekonomik Në fund të vitit më të fundmë të plotë financiar të audituar (i) Pasqyrat dhe/ose Raportet Financiare të Audituar të 3 viteve të fundit financiarë, që vërtetojnë vlerën neto të shoqërisë e llogaritur si diferencë ndërmjet totalit të aktivit dhe totalit të pasivit, e cila duhet të jetë të paktën 20 milion ⁸ Euro për secilin nga 3 vitet e fundit financiarë; dhe (ii) Pasqyrat dhe/apo Raportet Financiare të Audituar të të paktën të 3 viteve të fundit financiarë, që vërtetojnë një xhiro totale vjetore prej 20 milion EUR/vit për secilin nga 3 vitet e fundit financiarë	DKK3: Për pikën (i) dhe (ii): • Pasqyrat e plota Financiare të Audituar për 3 vitet e fundit ⁹ Pasqyrat financiare duhet të: - jenë audituar nga një auditor i pavarur; - të jenë të plota, përfshirë të gjithë shënimet e llogarive/pasqyrave financiare; dhe - të korrespondojnë me periudhat kontabël të mbyllura dhe të audituara (nuk kërkohet apo nuk do të pranohet asnjë pasqyrë për periudha kontabël të pjeshme). • Ofertuesi Potencial do të paraqesë deklaratën e auditorit që përcakton Vlerën Neto të Ofertuesit Potencial. • Formulari A1 bashkëlidhur këtu. • Vlera neto e Bashkimit të Shoqërive do të llogaritet si totali i të gjithë anëtarëve (që duhet të plotësojnë kriterin e pjesëmarrjes minimale në Bashkimin e Shoqërive). • Xhiro e Bashkimit të Shoqërive do të llogaritet si totali i të gjithë
--	--

⁸ Nëse pasqyrat financiare shprehen në një monedhë tjetër, ato do të konvertohen në EUR me kursin e këmbimit të Bankës Qëndrore Europiane në datën e publikimit të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Vlera në LEK do të krahasohet me vlerën ekuivalente në EUR me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e publikimit të njoftimit të marrëveshjes sipas këtyre Dokumenteve të KPK.

⁹ Ofertuesit Potencial që nuk i nënshtrohen kërkesave të ligjit për auditim, duhet të paraqesin pasqyrat financiare që kanë dorëzuar pranë autoriteteve përkatëse.

FORMULARI A1

OFERTUESI POTENCIAL: [•]

INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

1.	Emri:		
2.	NIPT / Nr identifikues:		
3.	Adresa e zyrave qendrore:		
4.	Tel:		
	Faks		
	Teleks:		
	E-mail:		
5.	Certifikata e Regjistrimit/matrikulimit	 (numri, data dhe vendi i regjistrimit/ matrikulimit)	
6.	Fusha e veprimtarisë:	 (në përputhje me dispozitat e statutit, aktit të themelimit, ose dokument te ngjashem)	
7.	Vlera Neto për 3 vitet e fundit të Ofertuesit Potencial		
	Viti	Vlera Neto më 31 dhjetor [•] ([në monedhë origjinale])	Vlera Neto më 31 dhjetor[•] (në euro)
1.			
2.			
3.			
8.	Xhiro për 3 vitet e fundit të Ofertuesit Potencial		
	Viti	Xhiro vjetore,më 31dhjetor [•] ([në monedhë origjinale])	Xhiro vjetore, më 31dhjetor[•] (në euro)
1.			
2.			
3.			

9.	Emri i personit që mund të kontaktohet nga Autoriteti Kontraktues për t'i kërkuar sqarime, bashkë me adresën dhe numrin e telefonit ku mund të kontaktohet ky person, nëse është i ndryshëm nga ai më sipër.	
----	--	--

Ofertuesi Potencial,
.....
(nënshkruesi i autorizuar)

FORMULARI A2

OFERTUESI POTENCIAL: [•]

PËRVOJA E NGJASHME¹⁰

1.	Emri dhe objekti i marrëveshjes:			
2.	Numri dhe data e marrëveshjes:			
3.	Emri i përfituesit/klientit:			
4.	Adresa e përfituesit/klientit:			
5.	Shteti:			
6..		Vlera e marrëveshjes (në datën e nënshkrimit)	(e shprehur në monedhën në të cilën është lidhur marrëveshja)	E shprehur në Euro ¹¹
	1.			
	2.			
	3.			
7.	A ka pasur procese gjyqësore në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve kontraktore, ku Ofertuesi Potencial të ketë qenë i paditur, natyra dhe mënyra sesi janë zgjidhur.			
8.	Burimi i energjisë së Rinovueshme (diellore, eolike,biomasë, hidro...)			
	Kapaciteti Total (MW)			
10	Data e kolaudimit			
11	Aktivitetet e Ofertuesit Potencial		☐ Zhvillim ☐ EPC/ndërtim ☐ Operim	

Ofertuesi, [•]
(nënshkruesi i autorizuar)

¹⁰Të plotësohen fletë të tjera për çdo kontratë, të cilat do të konfirmohen me kërkesë të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve për Kualifikim.

¹¹Të konvertohet në EUR duke përdorur kursin e publikuar nga Banka Qendrore Europiane, në datën e publikimit / të njoftimit të Dokumentave të Procedurës Konkurse. Shuma në Lek mund të konvertohet në Euro duke përdorur kursin e Bankës së Shqipërisë në datën e publikimit të njoftimit të Dokumentave të ProceduresKonkurse.

SHTOJCA 5

DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE PENALE

(për tu plotësuar nga Ofertuesi Potencial)

Deklaratë e Ofertuesit Potencial pjesëmarrës në procedurën Konkurruese që do të zhvillohet në datë [•], të shpallur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë për Projektin me vlerë marrëveshje [•].

Unë, i nënshkruari [•] në cilësinë e [•] të Ofertuesit Potencial [•] deklaroj se:

- Ofertuesi Potencial [•] nuk është dënuar për shkelje penale,
- Ofertuesi Potencial [•] nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, në lidhje me aktivitetin e tij profesional.

Data e deklaratës: [•]

Përfaqësuesi i Ofertuesit Potencial

Nënshkrimi

Vula

SHTOJCA 6
VETËDEKLARIM PËR OFERTUESIT POTENCIAL TE HUAJ
(për tu plotësuar nga ofertuesit e huaj, apo çdo anëtar i huaj i Konsorciumit)

Për pjesëmarrjen konkurrese [vendosni emrin e procedurës ketu] të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë

Për: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë

Datë: [data këtu]

[Emri Ofertuesit Potencial/Anëtarit Kryesues të Bashkimit të Shoqërive] deklaron dhe garanton që, në datën e kësaj letre [Emri Ofertuesit Potencial/Anëtarit Kryesues të Bashkimit të Shoqërive] [dhe çdo anëtar i Bashkimit tonë të Shoqërive (nëse ka)]:

1. Është i regjistruar rregullisht, është aktiv dhe nuk i është nënshtruar procedurave të falimentimit ose tëlikuidimit;
2. nuk është dënuar për mashtrim, falsifikim, korrupsion apo pastrim parash apo për vepra penale të kryera gjatë ushtrimit të aktivitetit profesional;
3. nuk është nën hetim penal për mashtrim, korrupsion, falsifikim ose pastrim parash në datën e dorëzimit të Aplikimit për Kualifikim dhe gjatë tre (3) viteve të fundit përpara dorëzimit të Aplikimit për Kualifikim;
4. nuk është skualifikuar nga tendera apo procedura të prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë;
5. nuk është përjashtuar, në bazë të listës së sanksioneve publike të ndonjëres prej bankave të zhvillimit shumëpalësh, që është palë në Marrëveshjen për Zbatimin e Përbashkët të Vendimit të Përjashtimit të datës 9 prill 2010 (www.crossdebarmen.org), ose nuk është i përfshirë në listën e sanksioneve të shpallur nga Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara ose nga Komisionet e tij, apo në ndonjë listë tjetër të njohur ndërkombëtare sanksionesh; ose në asnjë mënyrë tjetër nuk është i përfshirë (drejtpërdrejt apo përmes degëve) në veprimtari që nuk janë në përputhje me sanksionet e shpallura nga Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara apo nga Komisionet e tij apo me sanksionet kombëtare në Republikën e Shqipërisë.
6. nuk ka detyrime tatimore të papaguara, kontribute të sigurimeve shoqërore të papaguara apo detyrime të tjera të papaguara në lidhje

me vendime të nxjerra nga procese gjyqësore penale gjatë periudhës
prej jo më pak e tre vjetësh përpara datës së publikimit të
Dokumenteve të ProcedurësKonkuruese.

Me respekt,

Nënshkruesi i Autorizuar

Emri dhe Pozicioni

i Nënshkruesit

Emri i Ofertuesit

Potencial

Adresa

SHTOJCA 7

SPECIFIKIMET TEKNIKE MINIMALE

A. Specifikimet Teknike të Centralit Eolik

1. Madhësia e Projektit

Projekti do të identifikohet si një park eolik në tokë me një fuqi nominale që varion nga 10 deri në 75 MW, që do të përfitojë nga masat mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, veçanërisht nga energjia e erës, vendosur nga Qeveria e Shqipërisë nëpërmjet Plan-Veprimit Kombëtar për Energjinë e Rinovueshme 2019-2020 (miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 580 datë 28.08.2019).

2. Kërkesat specifike të Vendndodhjes

Zgjedhja e Vendndodhjes që do të përdoret për realizimin e Projektit Eolik i është lënë zhvilluesit me kusht që Vendndodhja të zgjidhet në përputhje me udhëzimet e njohura për zhvillimin e parqeve eolike tokësore që përdoren zakonisht në Evropë, siç janë prania e një burimi të përshtatshëm të erës, të rrjetit elektrik me voltazh të lartë, pajtueshmëria me kriteret mjedisore dhe sociale të zbatueshme për zonën (studimi i VNMS).

a. Fushata për matjet e erës

Shqipëria është një vend që ka një reliev që varion nga vargjet malore në vijat bregdetare kodrinore të karakterizuara nga ndryshime të konsiderueshme të lartësisë, pika-nisja kryesore për Projektin Eolik është një vlerësim i saktë i potencialit të energjisë së erës (në terma të rendimentit të energjisë) të çdo vendi të veçantë përmes kryerjes së një fushate për matjen e erës në vendndodhje me përdorimin e matëse profesionale.

Si rrjedhojë, zgjedhja e një vendi të duhur të Projektit Eolik kërkon para së gjithash disponueshmërinë e të dhënave cilësore të erës që disponohen ose që duhet të mblidhen në vendndodhje nëpërmjet shtyllave matëse. Duke e krahasuar me praktikën e zhvillimit të parqeve eolike në vendet fqinje me terrene kodrinore dhe malore, si Italia dhe Greqia, disponueshmëria e të dhënave cilësore të matjes së erës ka një ndikim të drejtpërdrejtë në afatet e ndërtimeve të parqeve eolike të përbëra nga më shumë se katër turbina ose që kanë fuqi nominale mbi 10 MW.

Rrjedhimisht, kryerja e një fushate cilësore për matjen e erës është etapa themelore për realizimin e Projektit Eolik me madhësi prej 10 deri 75 MW.

Një fushatë cilësore për matjen e erës, e përshtatshme për vlerësimin e saktë të potencialit të gjenerimit të energjisë së erës në një vend të veçantë për qëllime të financimit të parkut eolik, do të përfshijë kriteret e mëposhtme:

- një kohëzgjatje minimale prej një viti, duke përfshirë një sezon të tërë dimëror (nëntor-prill);
- vendosja e dy ose më shumë shtyllave matëse për një vendndodhje të caktuar, mundësisht

- një shtyllë për çdo 5-8 turbina ose kapacitet 10-20 MW (për një terren kompleks numri i shtyllave është më i ulët dhe për një terren të thjeshtë numri i shtyllave është më i lartë);
- lartësia e shtyllës së matjes të jetë sa më afër të jetë e mundur me lartësinë e kullës së turbinës (WTG) (mundësisht > 2/3 e lartësisë së vendodhjes së turbinës). Minimalisht, shtyllat duhet të jenë me një lartësi prej 40 metrash por mundësisht, shtyllat duhen të jenë me lartësi mbi 60 metra për shkak të saktësisë më të mirë në vlerësimin e rendimentit të energjisë, veçanërisht duke patur parasysh lartësitë aktuale të turbinave në tokë (80 deri në 100 metra);
 - shtyllat matëse duhet të kenë të paktën tre pika matjeje të instaluar në krahë me një gjatësi minimale prej 1 metër të instaluar në majë të shtyllës dhe në një lartësi të ndërmjetme me një minimum prej dy anemometrash dhe dy anemometra kupë të instaluar në dy lartësi të ndryshme;
 - rekomandohet: përdorimi i anemometrave rezervë në mënyrë që ulet mundësia e humbjes së matjeve për shkak të hijes së kullës ose dështimit të sensorit. Rekomandohet përdorimi i krahëve të gjatë për të minimizuar ndikimin e shtrembërimit të rrjedhës;
 - shtyllat matëse duhet të përfshijnë një sensor barometrik të presionit dhe temperaturës së ajrit;
 - shtyllat matëse duhet të jenë të pajisuara me instrumentacion të kalibruar sipas normave IEC-61400-12-1;
 - të dhënat e shpejtësisë dhe drejtimit të erës duhet të regjistrohe në interval 10 minutash nga regjistruesi i të dhënave: sigurohuni që të dhënat e papërpunuara të arkivohen dhe të ekzistojë një gjurmueshmëri për korrigjimet e të dhënave, në mënyrë që të dhënat të verifikohen në mënyrë të pavarur;
 - regjistrimi i të dhënave të presionit barometrik dhe temperaturës së ajrit.


b. Vendosja e turbinws (WTG) dhe mikrositimi i Vendodhjes

Bazuar në rezultatet e fushatës së matjes së erës dhe në relievin e vendndodhjes, do të pwrcktohet një skemë dhe mikrositim (pwrckaktimi i saktw i vendndodhjes) i parë i turbinws duke përdorur një softuer profesional të mikrositimit. Një softuer i tillë duhet të funksionojë duke kombinuar karakteristikat specifike të erës në vendndodhje (shpejtësia, drejtimi, turbulenca) me relievin e terrenit dhe duhet të lejojë vlerësimin e prodhimit të energjisë elektrike bazuar nw inpute manuale tw ndryshme tw zhvilluesit në lidhje me pozicionimit e turbinws, si lloje të ndryshme tw turbinw (madhësia, kurba e energjisë, prodhuesi) .

Softueri gjithashtu duhet të marrë në konsideratë kërkesat minimale të distancës për parqet e turbinave me erë qw varen nga madhësia e turbinws (lartësia e aksit tw turibnws, diametri i rotorit) dhe kufizimet e turbulencës së erës në përputhje me praktikatat e mira të projektimit të parqeve eolike sikurse janë paraqitur në diagramin vijues.

Softueri do të marrë gjithashtu në konsideratë praktikatat mw tw mira nw lidhje me distancimin e kullave tw parkut eolik të vendosura në terren të rrafshët - për minimizimin e humbjeve të energjisë kullat eolike nw tw njwjtin grup duhet të jenw tw distancuara në intervalin nga 6 deri në 9 diametra të rotorit ose distanca midis kullave eolike në të njëjtën grup të jetë në intervalin prej 3 deri në 5

diametra të rotorit.



Vlerësimi i nwpwrmjet softuerit tw *mikrositing* është një tjetër hap themelor nw zhvillimin e parkut eolik pasi mund të japw vlerësime të pwrditwsuara të prodhimit të energjisë elektrike në rast se skica fillestare e parkut duhet tw ndryshohet për shkak të kriterëve të studimit VNMS ose qw imponohen nga autoritetet mjedisore, ose pwr shkak se zhvilluesi ndryshon llojin e turbinws në bazë të parametrave të tjerw (çmimi, koha e dorëzimit, etj.).

3. Specifikimet cilësore të turbinave (WTG)

Turbinat për parqet e mëdhenj eolik në tokë janë tashmë një teknologji e konsoliduar dhe prodhuesit e kualifikuar botërorë të tyre janë një numër i vogël i firmave të mirënjohura, të certifikuar sipas standartit IEC 61400, *class 2*, që kanë referenca mbi mijëra turbina të madhësive të ndryshme të instaluara. Teknologjia e konsoliduar e turbinave është ajo e turbinave me induksion të dyfishtë me tre tehe (Double Feed Induction Generator), të cilat optimizojnë prodhimin e energjisë duke kontrolluar shpejtësinë e rotorit. Turbinat që përdorin pajisjet e kontrollit të shpejtësisë së rotorit të tilla si kuti marshesh mekanike ose turbina magnetike të përhershme me sinkronizim shumë polësh (*multi-pole synchronous permanent magnet generators*) janë teknologji që kanë dhënë provat e tyre dhe kanë regjistruar miliona orëve operimi.

Turbinat duhet të projektohen në përputhje me versionet më të fundit të Standardeve IEC 61400 të zbatueshme për Turbinat me Erë të Klasit 2 dhe të plotësojnë kërkesat për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit sipas kërkesave të KE. Kodet e zbatueshme raportohen në tabelën vijuese:

Parametri për Dizenjot	Kodi i Zbatueshëm
Kriteret për Dizenjon	IEC 61400-1:2005 + AMD1:2010

Kriteret për Dizenjon e kutive të shpjetësisë së turbinave eolike	IEC 61400-4:2012
Kriteret për Dizenjon e kullës dhe bazës	IEC 61400:6:2020
Matja e fuqisë së prodhimit të energjisë nga turbinat eolike sipas anenometrisë së shportës (nacelle)	IEC 61400-12-2:2013/COR1:2016
Matja dhe vlerësimi i karakteristikave të cilësisë së energjisë së turbinave eolike të lidhura me rrjetin	IEC 61400-21:2008
Testimi dhe certifikimi i konfomitetit	IEC 61400-22:2010
Testimi struktur i plotë i helikës	IEC 61400-23:2014
Mbrojtja nga ndriçimi	IEC 61400-24:2010
Teknikat për matjet e ndotjes akustike	IEC 61400-11:2012
Komunikimet për monitorimin dhe kontrollin e impianteve eolike për prodhimin e energjisë	IEC 61400-25-1; IEC 61400-25-2; IEC 61400-25-3; IEC 61400-25-4; IEC 61400-25-5; IEC 61400-25-6
Disponueshmëria kohore për sistemet prodhuese të turbinave eolike	IEC TS 61400-26-1:2011
Disponueshmëria prodhuese e turbinave eolike	IEC TS 61400-26-2:2014

Garancia e Turbinës

Garancia e kërkuar për Turbinën është garancia sipas kontratës së IEC 61400 klasa 2 për pajisjet Turbina. Garancia standard zakonisht përbëhet nga dy pjesë:

- Garancia për Kurbën e Prodhimit të Energjisë (garanton rezultatin e prodhimit të energjisë si funksion karakteristik eolik)
- Garancia e Disponueshmërisë (garanton mbrojtjen nga ndërprerjet e prodhimit të energjisë për shkak të Turbinmës).

Garancitë tipike të kontratës së furnizimit të Turbinës janë 90 deri 95% për Garancinë për Kurbën e Prodhimit të Energjisë dhe 95% për Garancinë e Disponueshmërisë. Peroudha tipike e garancisë zakonisht është dy vite nga data e fillimit të operimit të parkut eolik. Garancitë tipike të kontratës së furnizimit të Turbinës (p.sh Kurba e Prodhimit të Energjisë dhe Disponueshmëria) pas mbarimit të periudhës së garancisë do të jepen nga një O&M apo një kontratë shërbimi që do të propozohet nga një shërbim për prodhimin e e Turbinës apo nga një ofrues shërbimi i kualifikuar O&M për Turbinat.

4. Balancimi i Impiantit të Parkut Eolik (BII)

Kabllo të nëntokësorë nga çdo tek nënstacioni i prodhimit MV (nëse ka) apo nënstacioni HV do të jenë konform praktikave të mira për parqet eolike dhe standartet lokale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të aplikueshme.

5. Transformatorët dhe Pajisjet Elektrike

Transformatorët HV dhe Pajisjet Elektrike HV do të jenë konform kodeve IEC/EN dhe kodit përkatës të rrjetit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit lokal. Pajisjet Elektrike MV do të jenë konform standarteve EN.

6. Garancia e BII

Punët civile dhe elektrike të BII (kabllot nëntokësorë, transformatorët dhe Pajisjet Elektrike MV dhe HV) do të garantohen për një periudhë minimale operationale prej 10 vitesh. Dizenjo e nënstacionit HV do të jetë konform kodeve IEC.

Parametri për Dizenjot	Kodi i Zbatueshëm
Analiza mjedisore	IEC 60068-2 / IEC 62093
Konformiteti Elektromanjetik (KE)	IEC 61000-6-2, IEC 61000-6-4 dhe pjesë të tjera detyruese IEC 61000
Siguria Elektrike	IEC 62103/ 62109-1&2
Izolimi i Rrjetit	IEEE1547/IEC 62116/ UL1741 apo Standarte ekuivalente BIS
Konformiteti me kalimin e tensionit të ulët (LVRT)	Sipas udhëzimeve/manualëve/rregulloreve CERC
Lidhja në Rrjet	Manualet repektivë CERC (përfshirë konformitetin me kalimin e tensionit të ulët (LVRT) dhe Kodin e Rrjetit me ndryshime e rishikuar periodikisht
Kapaciteti HV i vlerësuar i nënstacionit	Prodhimi i rankuar i çdo Turbine shprehur në kW shumëzuar me numrin e Turbinave të instaluar, do të konsiderohet si kapaciteti i rankuar i parkut eolik për nevojat e dizenjos së HV

7. Termat e referencës për Studimin e Para-fizibilitetit

Studimi i para-fizibilitetit duhet të adresojë çështjet e mëposhtme në përputhje me udhëzimet e konsoliduara dhe të njohura për financimin e parqeve eolike tokësorë që të garantojë një proces të lehtë për realizimin e parkut eolik:

- prezenca e një burimi të përshtatshëm eolik;
- prezenca e linjave të prodhimit të përshtatshme /të përmirësueshme HV;
- akses i përshtatshëm në Vendndodhje për transportin e Turbinave;
- konfomitet me ambjentin ekzistues në Vendndodhje dhe kufizimet mjedisore;
- cilësia e Turbinës;
- përshtatshmëria me dizenjon e parkut eolik (micrositing) distancat e kullave të Turbinës.);
- vlerësimi i ndikimit në zonat vendore të banuara dhe në punësim.

Dok. Nr.	TË DHËNAT TEKNIKE
Paragrafi A - Vlerësimi i Burimeve të Energjisë së Erës dhe ndërtimi i parqeve eolike	
A.1	Skica e instalimit dhe raporti i te dhenave te eres nga shtylla e matjes
A.2	Karakteristikat e Burimit të erës (cilësia and vlerësimi)
A.3	Studimi i vendosjes dhe pozicionimit të turbinave në parkut eolik dhe vlerësimi i nivelit të prodhimit të energjisë elektrike (programi/software i përdorur)
A.4	Rishikimi istudimit të vendosjes së turbinave eolike duke përfshire pengasat e mundshme mjedisore

Dok. Nr.	TË DHËNAT TEKNIKE
Paragrafi B– Përshkrimi i Pajisjeve TGJE(Turbina e Gjenerimit të Erës) te propozuara	
B.1.	TGJE – Karakteristikat teknike të dizanjit
B.2	TGJE – Referencat e prodhuesit për instalimet e mëparshme të parqeve eolike (Evropë)
B.3	TGJE – Referencat e prodhuesit për instalimet e kryera në terren të thyer malor (nëse është e nevojshme)
B.4	TGJE – Përputhshmëri me kodet, garancitë e IEC 61400 (kurba e energjisë dhe kohëzgjatja)
B.5	TGJE – Projektimi strukturor i kullës dhe projekti i themelit
B.6	TGJE – Përshkrimi i pajisjeve mekanike, dizajni, certifikimi i zbatueshëm
B.6.1	TGJE – Nacelle/Shporta
B.6.2	TGJE – Rotori dhe fletet
B.6.3	TGJE – Kutia e shpejtësisë dhe gjeneratori
B.6.4	TGJE – Sistemi rrotullues Yaw
B.6.5	TGJE – Ashensori dhe shkallët e Kullës
B.7	TGJE – Përshkrimi i pajisjeve elektrike dhe certifikimet përkatëse
B.7.1	TGJE - Transformatori
B.7.2	TGJE – Pajisje ndërprerëse/Switchgear
B.7.3	TGJE – Dhoma e motorit dhe kabujt tokësorë të Kullës
B.8	TGJE – Përshkrimi i sistemit të kontrollit dhe specifikimet e ndërfaqes (SCADA)
B.9	TGJE - Karakteristikat e aksesimit dhe sigurisë së Shportës (Nacelle)
Paragrafi C – Projektimi i Balancës së Propozuar të Impiantin (BPI)	
C.1	Projektimi i dizanjit BOP të Pajisjeve elektrike (diagram me një vijë)
C.2	Projektimi dhe paraqitja e kabinës MV (nëse përfshihet)
C.2.1	Pajisje elektrike -MV XXXkV/YYYkV Ndërprerës Qarku - Të dhënat
C.2.2	Pajisje elektrike - MV XXXkV/YYYkV kablllo - Të dhënat
C.3	Projektimi dhe paraqitja e nënstacionit HV
C.3.1	Pajisje elektrike -HV XXXkV/YYYkV Ndërprerës Qarku – Të dhënat dhe Raporti testimit
C.3.2	Pajisje elektrike - HV XXXkV/YYYkV kablllo - Të dhënat
C.3.3	Pajisje elektrike -MV/HV XXXkV/YYYkV Ndërprerës Qarku - Të dhënat dhe raporti i testimit
C.3.4	Pajisje elektrike - HV XXXkV/YYYkV Pajisje Ndërprerëse/Switchgear – Të dhënat dhe raporti i testimit
C.3.5	Pajisje elektrike – Pajisjet Ndhimëse - Të dhënat dhe raporti i testimit
C.3.6	Sistemet I&C – Monitorimi dhe Kontrolli në distancë i Parkut Eoklik - Të dhënat
C.3.7	Sistemet I&C – Regjistruesi i të dhënave të Parkut Eoklik– Të dhënat
C.3.8	Sistemet I&C – HV Platforma e Kontrollit të Nënstacioneve – Të dhënat
C.3.9	Sistemet I&C – Transferimi i të Dhënave të Nënstacioneve TGJE SCADA dhe HV – Të dhënat
C.3.10	Sistemet I&C – Krahassimi i matjes bazë të erës - Ruajtja e regjistruetit të të dhënave dhe transferimi i të dhënave
Paragrafi D – Kualifikimi i Kontraktorëve, Furnizuesve dhe Nënkontraktorëve	
D.1	Matja e Erës – Kualifikimi i furnizuesit të pajisjeve dhe instalimi i shtylles matëse

Dok. Nr.	TË DHËNAT TEKNIKE
D.2	<i>Projektimi i parkut eolik - Referencat e konsulentit të erës dhe lloji i softuerit micrositing dhe për matjen e rendimentit të energjisë të përdorur</i>
D.3	<i>Furnizuesi EPC - Informacion i përgjithshëm dhe lista e referencave të parkut eolik</i>
D.4	<i>Furnizuesi i TGJE– Informacion i përgjithshëm dhe lista e referencave të instaluar në parkun eolik</i>
D.5	<i>Ofruesi i Punimeve Civile - Lista e referencave për themelet e TGJE, rrugët hyrëse dhe kabllot nëntokësore</i>
D.6	<i>Furnizuesi i Pajisjeve Elektrike - Lista e referencave për punimet e transformatorëve dhe çelsave HV</i>
D.7	<i>Furnizuesi O&M - Informacione të përgjithshme dhe lista e referencave</i>
D.8	<i>Nënkontraktues të tjerë - Informacione të përgjithshme</i>
Paragrafi E - Vlerësimi i ndekimit mjedisor dhe shoqëror (VNMS)	
E.1	<i>Topografia (përshkrimi i përgjithshëm dhe hartat)</i>
E.2	<i>Kufizime historike, kulturore dhe mjedisore (ruajtja e distancës nga zonat e banuara)</i>
E.3	<i>Zona të mbrojtura, Habitata Natyror, Karakteristika Prioritare të Biodiversitetit dhe Habitatit Kritik</i>
E.4	<i>Gjeologjia dhe hidrogeologjia (përshkrimi i përgjithshëm dhe hartat)</i>
E.5	<i>Studim i habitateve të kafshëve të egra (ndikimi tek shpendët, lakuriqët e natës, fauna dhe flora e vendndodhjes)</i>
E.6	<i>Ndikimi i rrugëve hyrëse në platformat e ndërtimit të TGJE</i>
E.7	<i>Kërkesat për punime tokësore dhe kullimi</i>
E.8	<i>EMC dhe ndikimi i peizazhit të nënstacioneve dhe linjave elektrike ajrore HV</i>
E.9	<i>Ndikimi akustik i ndërtimit të TGJE-ve në zonat e banuara</i>
E.10	<i>Vlerësimi i jetëgjatësisë së parkut eolik dhe azhurnimet e mundshme</i>
E.11	<i>Vlerësimi i nxitjes së punësimit në zonë (i përkohshëm dhe fiks)</i>
E.12	<i>Përshkrimi i punës që nevojitet për çmontimin e parkut eolik pas amortizimit të tyre</i>
Paragrafi F – Informacion teknik për parqet eolike	
F.1	<i>Përshkrimi i përgjithshëm i Parkut të Erës</i>
	a. Përshkrimi i vendndodhjes së parkut me erë (numri i TGJE-ve) dhe nënstacionit të lidhjes së rrjetit
	b. Madhësia dhe karakteristikat teknike të TGJE (fuqia e vlerësuar, lartësia e shpërndarësit, gjatësia e turbinave, etj.)
	c. Komponentët elektrik të Nënstacionit HV: kablllo MV, Transformatorë MV / HV, pajisjet ndërprerëse (switchgears) MV dhe HV, kablllo MV, kablllo HV (nëse ka)
	d. Diagramat me një linjë të kablllove elektrike dhe pajisjeve të pajisjes me tabela të specifikimit të pajisjeve
	e. Sistemi i kontrollit dhe instrumentimit TGJE (SCADA) (përshkrimi i përgjithshëm i sistemit të kontrollit, shfaqja e sistemit të kontrollit, kabllot me fibra optike dhe protokollin e transmetimit të të dhënave, sistemi i matjes së erës, përshkrimi i sistemit të detektimit të zjarrit dhe sistemit të mbrojtjes së aksesit)
	f. Punimet Civile (skicat e TGJE-ve si ndërtime, përbërja dhe provat e betonit të themelit të TGJE, zonat e platformës së ngritjes së TGJE, rrugët hyrëse, rrugët e shërbimit, projektimi i kablllove nëntokësore, themeli dhe paraqitja e nënstacionit HV si vizatime të ndërtuara, sistemi i kullimit dhe mbrojtja ndaj korrozionit të strukturës së betonit dhe çelikut për punimet me beton)

Dok. Nr.	TË DHËNAT TEKNIKE
	g. Lista e kodeve, standardeve dhe rregulloreve të përdorura për hartimin e parkut me erë
F.2	Përshkrim i përgjithshëm i parkut me erë
F.3	Programi i përdorur për përcaktimin e vendosjes (micrositing)
F.4	Projektim i plotë i shtrirjes së parkut eolik, me rrugët e hyrjes, platformat e ngritjes dhe vendodhjen e kabllorë nëntokësore
F.5	Vendosja kabujve nëntokësor MV
F.6	Paraqitja e Diagramës dhe projektit të një linje të nënstacionit MV / HV
F.7	Detaje të sistemit të tokëzimit të nënstacionit TGJE dhe HV
F.8	Karakteristikat SCADA të TGJE dhe parkut eolik
F.9	Raporti i ndërtimit të parkut elik
	a. . Përshkrimi i përgjithshëm i fazave të ndërtimit dhe dorëzimit të parkut eolik (përfshirë përshkrimin e masave për sigurinë dhe shëndetin në punë, përshkrimin e pajisjeve të kërkuara, etj.)
	b. Planifikimi i burimeve njerëzore për ndërtimin dhe fazat e dorëzimit (përfshirë numrin dhe kualifikimet e punëtorëve të nevojshëm, periudhën minimale të pritshme për qëndrimin në vendndodhje, numrin e përgjithshëm të punëtorëve vendas të kërkuar, numrin e orëve të punës, kualifikimin dhe përvojën e punëtorëve vendas dhe të huaj, emrin dhe CV-të e menaxherit të projektit, menaxherit të Vendndodhjes dhe Drejtorit të Punimeve)
F.10	Raporti O&M i parkut eolik
	c. Përshkrimi i përgjithshëm i aktiviteteve të planifikuara O&M (mirëmbajtja e planifikuar, pajisjet e nevojshme, kualifikimet e fuqisë punëtore dhe siguria dhe shëndeti në punë, struktura organizative, inventari i pjesëve për këmbim dhe furnizimi)
	d. Aktivitete e nevojshme për mirëmbajtjen e paplanifikuar dhe mirëmbajtja e aspekteve kryesore (Pajisjet e kërkuara, kualifikimet e fuqisë punëtore dhe HSE, disponueshmëria e pjesëve kryesore të këmbimit)
	e. Personeli i Shërbimit në terren (numri i personelit të shërbimit në terren, CV-të dhe kualifikimet, vendndodhja e mjediseve O&M të personelit në terren dhe emri i menaxherit, orari i planifikuar i aktiviteteve të mirëmbajtjes, aftësitë gjuhësore, detajet e kontaktit të personelit teknik dhe administrativ)
	f. Raportimi Ditari regjistrimit (logbook) të TGJE-së duke përfshirë listën e ndërprerjeve/shkëputjeve të ndodhura dhe veprimet e riparimit të kryera, humbjet e prodhimit të energjisë, koha dhe kohëzgjatja e ndërprerjeve, sugjerimi i veprimeve të përmirësimit, lista e ndërprerjeve që përshkruhen nga BPI dhe shkaqet e jashtme (paqëndrueshmëria e rrjetit, moti ekstrem, etj.)
F.11	Draft i planit të menaxhimit të HSE (gjatë fazës së Ndërtimit dhe O&M)
F.12	Procedurat administrative në lidhje me fazat e ndërtimit dhe O&M

SHTOJCA 8
FORMULARI I NJOFTIMIT TË OFERTUESIT POTENCIAL TË
SKUALIFIKUAR

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e
autoritetit kontraktues]

[Adresa e ofertuesit
Potencial]

I/E nderuar Z./Zj. <emri i personit të kontaktit>

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur, e kryer në përputhje me Ligjin nr. 7/2017 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 349/2018, datë [•], të ndryshuar.

Aplikimi për Kualifikim juaj u vlerësua me kujdes sipas kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në Dokumentet e KPK dhe në dosjen e Aplikimit për Kualifikim.

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni [skualifikuar], për shkak të arsyeve të mëposhtme

Nëse ju besoni se Autoriteti Kontraktues është në shkelje të VKM-së nr. 349/2018 gjatë procedurës së konkurimit, ju keni të drejtën të paraqisni një ankesë formale Autoritetit Kontraktues, brenda 5-ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, ne shpresojmë se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

(AUTORITETI KONTRAKTUES)

SHTOJCA 9
FORMULARI I NJOFTIMIT TË OFERTUESIT TË PARA-KUALIFIKUAR
(formular për tu plotësuar nga Autoriteti
Kontraktues)

Datë: [data këtu]

Për: (Emri dhe adresa e Ofertuesit të Para-Kualifikuar)

Përshkrim i shkurtër i Procedurës së Prokurimit:

Njoftojmë me anë të kësaj se, kanë qenë pjesëmarrës në tender Ofertuesit Potencial e mëposhtëm, duke ofruar secili:

1.) _____
2. _____
3. _____) _____ 4.....

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
2. _____

Arsyet e Skualifikimit: _____

Referuar procedurës së mësipërme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë njofton [emri dhe adresa e Ofertuesit Fitues] se Aplikimi për Kualifikim e paraqitur më datë [data] në lidhje me Projektin, është pranuar.

Nëse Autoriteti Kontraktues do të vendosë të vazhdojë me fazën e KPP, autoriteti do të ftojë Ofertuesit që të paraqesin KPP sipas kalendarit me ndryshime si do të vendoset nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues do të trajtojë Ofertuesit Potencial në mënyrë të barabartë dhe të ngjashme.

Në rast se Ofertuesi Potencial nuk dëshiron të marrë pjesë në fazën e KPP, , ju duhet të njoftoni me shkrim Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë.

Njoftimi i klasifikimit është bërë më _____ Ankesa: Po/Jo _____

Nëse Po, përgjigjia e marrë më _____

Autoriteti Kontraktues

[emri, nënshkrimi dhe vula]

SHTOJCA 10
FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT KONTRAKTUES

Ankesë drejtuar: Autoritetit Kontraktues

Seksioni i Identifikimit i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një Ofertues Potencial ose Ofertues i mundshëm (p.sh., individ, partneritet, bashkim shoqërisht, dhe konsorcium).

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shkruani)

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Adresa elektronike (e-mail)

Emri dhe pozicioni i personit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shkruani)

Firma e personit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksine zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksine zonës)

Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

Vendosni numrin e kontratës specifikuar në njoftimin e kontratës ose në Dokumentet e Procedurës Konkurruese, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për procedurën konkurruese të ankimuar.

2. Autoriteti Kontraktues

Emri i autoritetit kontraktues që administron procesin

2. Vlera e Projektit

Llogaritja e vlerës së kontratës (vlera e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. Objekti i Kontratës

Përshkrim i shkurtër i Projektit

4. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Aplikimit për Kualifikim

Afati përfundimtar për dorëzimin e Aplikimeve për Kualifikim.

Data (viti/muaji/dita)

5. Data e marrjes së Njoftimit

Data (viti/muaji/dita)

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

(Përshkruani shkeljet lidhur me vendimet, aktet, dokumente etj.,)

2. Detaje të hollësishme të fakteve dhe argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet përkatëse të dokumenteve të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

3. Lista e Shtojcave

Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar rregullisht, ajo duhet të jetë e plotë.

*Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumenteve që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumenteve. Dokumentet duhet të përfshijnë **çdo njoftim të publikuar, të gjitha Dokumentet e KPK , me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj.** Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumenteve përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Shënim: Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë Autoritetit Kontraktues.

4. Kundërshtimet Paraprakendaj Autoritetit Kontraktues

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejtpërdrejt Autoritetit Kontraktues. Bashkangjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.

1.Keni bërë ndonjë kundërshtim? Nëse po, ju lutem specifikoni mënyrëne kundërshtimit (p.sh, me shkrim, nëpërmjetfaksit,etj.,);

Q Po

Q Jo

2. Emri i Autoriteti Kontraktues pranë të cilit është paraqitur Kundërshtimi

(Emri dhe pozicioni i Nëpunësit/Personit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.)

3.Natyra e Masës së KërkuarKorrigjuese

Shpreheni me shkrim çfarë mase korrigjuese kërkon?

4. Lista

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar rregullisht, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumenteve që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumenteve. Dokumentet duhet të përfshijnë **çdo njoftim t'epublikuar, të gjitha Dokumentet e KPK, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë.** Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumenteve përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës,të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **Autoritetit Kontraktues.**

Nr.Faks:

E-mail:

Nënshkrimi dhe Vula e ankuesit

SHTOJCA 11
FORMA E PROKURËS SË POSAÇME
(PËR TU PËRGATITUR NGA OFERTUESI POTENCIAL)

Sot më datë [data], përpara meje, Noterit [të dhënat e Noterit], une i/e nënshkruari / nënshkruara [emër, mbiemër], lindur më [data], në [vendi, shteti], identifikuar me pasaportë no. [no. i pasaportës], në cilësinë e [pozicioni] në [Ofertuesi Potencial / Bashkimi i Shoqërive], i jap këtë procure të posaçme, Z./Znj. [emër, mbiemër], lindur më [data], në [vendi, shteti], identifikuar me pasaportë no. [no. i pasaportës], **(Përfaqësuesi)**, për të përfaqësuar [Ofertuesin Potencial/ Bashkimin e Shoqërive], në procedurën konkurruese “Për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, dhe transferimin e Impiantit Fotovoltaik me Panele Diellore me kapacitet të instaluar 10 MW dhe 75 MW (përfshirë), si pjesë e masave mbështetëse me vendndodhje si do të vendoset nga Ofertuesi Potencial brenda në Republikën e Shqipërisë ” **(Procedura Konkurruese)** organizuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë **(Autoriteti Kontraktues)**. Përfaqësuesi autorizohet të:

- (a) përfaqësojë Ofertuesin Potencial / Bashkimin e Shoqërive në Procedurën Konkurruese, përpara Autoritetit Kontraktues;
- (b) ekzekutojë / firmosë dhe dorëzojë të gjitha Dokumentat e KPK, duke përfshirë por pa u kufizuar gjithashtu edhe anekset, Aplikimi për Kualifikim financiar, ashtu siç janë përgatitur nga Ofertuesi Potencial / Bashkimi i Shoqërive, dhe ti dorëzojë ato pranë Autoritetit Kontraktues, në përputhje me KPK ;
- (c) të firmosë, në emër dhe për llogari të Ofertuesit Potencial / Bashkimit të Shoqërive, të gjitha Dokumentat e KPK , që dorëzohen prej tij;
- (d) përfaqësojë Ofertuesin Potencial / Bashkimin e Shoqërive në korrespondencë, procedurën pyetje – përgjigje me Autoritetin Kontraktues;
- (e) në përgjithësi të përfaqësojë pa kufizime, Ofertuesin Potencial / Bashkimin e Shoqërive, në të gjitha çështjet, ashtu siç parashikohen në Dokumentat dhe procedurën e KPK

Ofertuesi Potencial / Bashkimi i Shoqërive do mbetet përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues dhe institucioneve në Republikën e Shqipërisë për të gjitha veprimet e Përfaqësuesit.

Unë, Noteri, [emër, mbiemër], çertifikoj firmosjen dhe ekzekutimin e kësaj procure të Posaçme, përpara meje, në vullentin e lirë të pales që e ka lëshuar këtë procure të posaçme , dhe e çertifikoj këtë dokument, në përputhje me Ligjin.

Ofertuesi Potencial / anëtari i Bashkimit të Shoqërive

Noter

SHTOJCA 12
INFORMACION MBI SHOQËRINË E OFERTUESVE POTENCIAL

Informacion për Ofertuesin Potencial	
Emri:	
Lloji: (Shoqëri, Ortakëri etj.)	
Nr. i regjistrimit tregtar:	
Selia:	
Adresa e zyrës qendrore:	
Numri i telefonit:	
Numri i faksit:	
Adresa e emailit:	
Objekti kryesor i veprimtarisë:	
Deklarata e aksionarit (bashkëngjiteni më vete)	

Informacion për Anëtarin e Konsorciumit (nëse ka, plotësoni të dhënat më poshtë për të gjithë anëtarët, duke identifikuar Anëtarin Kryesues)	
Emri:	
Lloji: (Shoqëri, Ortakëri etj.)	
Nr i regjistrimit tregtar:	
Selia:	
Adresa e zyrës qendrore:	
Numri i telefonit:	
Numri i faksit:	
Adresa e emailit:	
Objekti kryesor i veprimtarisë:	
Deklarata e aksionarit (bashkëngjiteni më vete)	

SHTOJCA 13
KALENDARI I PARASHIKUAR

Kalendari i parashikuar është vetëm për qëllime ilustrimi. Ky kalendar mund të ndryshohet nga Autoriteti Kontraktues nëse del e nevojshme.

Faza	Objektivi	Data
I	Njoftimi i KPK	15 qershor 2021
II	Konferenca për Ofertuesit Potencial	TBD
III	Afati për propozimin e amendimeve të Dokumentave të KPK	17 janar 2022
IV	Data e fundit për pranimin e pyetjeve nga Ofertuesit Potencial për të Dokumentat e KPK	12 maj 2022
V	Afati i Dorëzimit të Aplikimeve për Kualifikim	13 qershor 2022
VI	Hapja e Aplikimeve për Kualifikim	20 qershor 2022
VII	Afati për Rregullime gjatë fazës së vlerësimit në fazën e KPK	Korrik 2022
VIII	Shpallja e Ofertuesit te Para-Kualifikuar	Gusht 2022
IX	Publikimi KPP dhe afati për ndryshimet dhe sqarimet të Dokumentave të KPP	Shtator 2022
X	Afati i Dorëzimit të Aplikimeve për Kualifikim të fazës KPP	Shkurt 2023
XI	Shpallja e Ofertuesit te Perzgjedhur	Mars 2023

SHTOJCA 14 (Faza e KPK)

Termat e Referencës për Studimin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS)

Në fazën e KPK Ofertuesi i Para-Kualifikuar duhet të dorëzojë një Studim të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social të projektit ¹¹ në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe Praktikën e Mirë të Industrisë. Zhvilluesi duhet të përfundojë zhvillimin dhe operimin e projektit në përputhje me një VNMS të kryer sipas kërkesave të përcaktuara në këtë Shtojcë 14.

1. KËRKESAT E ZBATUESHME

VNMS do të hartohet në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- Legjislacionin Shqiptar si dhe standartet mjedisore themelore të EU, përfshirë (por jo kufizuar) ato të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Direktivë 2011/92/EU e 31 Dhjetorit 2011, e amenduar nga Direktiva 2014/52/EU) (përditësuar në 2014), Direktiva e Shkarkimeve Industriale 2010/75/EU, dhe Direktiva e Habitave dhe Shpendëve 2009/147/EC, 92/43/EEC. Në rast të diferencave midis Rregulloreve Shqiptare me ato themelore për standartet mjedisore të BE, Projekti do të plotësojë ato standartet të cilat janë më të larta (më të avancuara).
- Praktika e Mirë Ndërkombëtare e Industrisë për zhvillimin e fermave eolike, për shembull Udhëzuesit (2007) të Grupit të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë (MSHS), Udhëzuesit për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë për Energjinë e erës (2015), Njoftimin e Komisionit të BE “Dokument udhëzues për zhvillimin e energjisë së erës dhe legjislacionin e BE për natyrën” (C(2020) 7730) dhe Udhëzuesit të IUCN (2021) “Zbutja e ndikimeve në biodiversitet të lidhura me energjinë e diellit dhe të erës”.
- Standartet Sociale dhe Mjedisore si dhe kërkesat e huadhënësve të mundshëm, të tillë si Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN) dhe bankat tregtare që aderojnë me Parimet e Ekuadorit¹² (nëse janë të aplikueshme);
- Për zonat që mund të kenë një efekt në zonat candidate të rrjetit Natura 2000 ose rrjetit Emerald, ofertuesi i parakualifikuar do të përgatisë një Vlerësim të posaçëm në përputhje me kushtet e Nenit 6(3) dhe (4) të Direktivës së Habitave 92/43/EEC, dhe udhëzuesit metodologjik përkatës; dhe
- Projekti do të përfshijë të gjitha masat e arsyeshme për të shmangur, minimizuar, zbutur dhe kompensuar çdo ndryshim të dëmshëm në kushtet sociale dhe mjedisore, si dhe ndikimet në shëndetin dhe sigurinë publike.

2. OBJEKTIVAT E VNMS

VNMS do të identifikojë dhe vlerësojë çdo ndikim negativ potencial të rëndësishëm me pasoja sociale dhe mjedisore si pasojë e projektit të propozuar si dhe të përcaktojë masat e duhura për të parandaluar, minimizuar, zbutur dhe kompesuar këto ndikime të dëmshme. Gjithashtu VNMS do të identifikojë mundësitë dhe përfitimet sociale dhe mjedisore përfshirë ato që do të përmirësojnë qëndrueshmërinë sociale dhe mjedisore të Projektit. VNMS do të përfshijë çdo studim plotësues (p.sh ndryshimet klimatike, të drejta gjinore dhe të njeriut) që mund të kërkohet duke marrë parasysh kontekstin e projektit dhe rreziqet mjedisore dhe sociale. Procesi i vlerësimit do të jetë proporcional me rreziqet e mundshme dhe ndikimet e Projektit dhe do të përfshijë në mënyrë të integruar të gjithë ndikimet e drejtpërdrejta, të tërthorta e kumulative mjedisore dhe sociale si dhe ndikimet e projektit

¹¹ Termi “Projekt” përfshin fermën eolike dhe të gjitha instalimet e lidhura me të përfshirë linjën e transmetimit, nënstacionet etj.

¹² E disponueshme në: <https://equator-principles.com/>

sipas fazave të ciklit të plotë të zhvillimit të tij (psh, para ndërtimore, ndërtimore, operacionale dhe çmontimin ose mbylljen dhe rigjenerimin).

3. OBJEKTI I VNMS

Në përputhje me Kërkesat e Zbatueshme, VNMS do të përfshijë komponentët e mëposhtëm.

3.1 Përmbledhje ekzekutive

Një përshkrim të përmbledhur dhe konçiz për Projektin, qëllimin e tij, aktivitetet ekzistuese dhe kushtet e përgjithshme të zonës, ndikimet e rëndësishme mjedisore dhe sociale. Përmbledhja Ekzekutive do të përfshijë dhe të gjitha masat zbutëse, monitorimin e propozuar si dhe Dokumentin e Kompanisë me angazhimin për zbatimin e tyre.

3.2 Përshkrimi i Projektit

Përshkrim i përmbledhur i Projektit brenda kontekstit të tij gjeografik, mjedisor dhe socio-ekonomik. Këtu do të përfshihet dhe informacion nëse dhe se si Projekti është pjesë e një Plani/Programi më të Gjerë Zhvillimor. Krahësim sistematik i disa alternativave të mundshme të Projektit në terma vendodhje, teknologjie ose skicimi në terma të ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale, duke përfshirë dhe alternativën “Pa projekt”. Përshkrimi i Projektit duhet të përfshijë (por pa u kufizuar) informacionin e mëposhtëm:

- Planimetrinë e Projektit dhe nevojat për sigurimin e tokës për Projektin
- Planimetrinë e strukturave të ndryshme, në veçanti ato të ruajtjes të mbetjeve dhe karburantit, dhe ndonjë komponent tjetër që mund të gjenerojë shkarkime, zhurma, vibrime ose rreziqe për rrjedhje në mjedis;
- Skicën ilustruese të procesit
- Përshkrim të detajuar të teknologjive të projektit sipas fazave të njëpasnjëshme të procesit;
- Trafiku i automjeteve, sipas fazës ndërtimore dhe operacionale të Projektit;
- Kërkesat për punëtore sipas fazës ndërtimore dhe operacionale të Projektit; dhe
- Identifikimi i të gjitha proceseve me shkarkime të lëngta dhe gazesh, karakteristikat e biokimikateve në kushte normale funksionimi.

3.3. Analiza e alternativave të arësyeshme

VNMS do të përfshijë një analizë të alternativave të mundshme teknike dhe financiare, duke përfshirë alternativat “Pa projekt”. Gjithashtu VNMS do të ofrojë një justifikim për variantin e zgjedhur duke marrë në konsideratë efektet mjedisore dhe sociale të këtij varianti.

3.4. Kërkesat ligjore

Një përshkrim të politikës si dhe kontekstit ligjor dhe administrative të VNMS, duke përmbledhur legjisllacionin e përshtatshëm kombëtar si dhe kërkesat mjedisore dhe sociale të kredituesve dhe nëse është e zbatueshme dhe Konventat dhe Marrëveshjet rajonale dhe globale. Po ashtu duhet të pasqyrohen dhe afatet kohore për konsultimin publik si dhe ato për shqyrtimin e Projektit.

3.5 Gjendja ekzistuese

VNMS do të përfshijë një përshkrim gjithëpërfshirës të gjendjes aktuale dhe evoluimit të mundshëm (në mungesë të projektit) të mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik në zonën e ndikimit të projektit. Gjendja mjedisore dhe sociale për VNMS-në do të bazohet në të dhëna të fundit dhe do të konsistojë në një kombinim të studimeve tanimë të mbledhura dhe të disponueshme përmes organizatave lokale qeveritare dhe ndoshta jo-qeveritare si dhe vërtetimeve shtesë në terren sipas nevojës.

Në përputhje me kërkesat e Direktivës së BE-së për Habitatet dhe Direktivës për Shpendët, vlerësimi gjithashtu do të identifikojë çdo zonë të mbrojtur natyrore që mund të preket nga projekti. Kjo do të përfshijë zonat e mbrojtura të rrjetit Natura 2000 si dhe zonat Emerald dhe zona të tjera si Zona të Rëndësishme për Biodiversitetin dhe Zona të Rëndësishme për Shpendët.

Vlerësimi i gjendjes do të përfshijë shqyrtimin e marrëdhënieve ndërmjet faktorëve përkatës si dhe ekspozimin, çënueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e këtyre faktorëve ndaj rreziqeve të katastrofave natyrore dhe ndryshimeve klimatike.

Përshkrimi i aspekteve përkatëse të mjedisit fizik dhe natyror dhe kushteve socio-ekonomike të zonës së ndikuar nga aktivitetet aktuale dhe ato të projektit, do të përfshijë, ndër të tjera:

- Cilësia e ajrit dhe zhurmat;
- Burimet ekologjike dhe biologjike (fauna, flora, biodiversiteti, llojet e mbrojtura, habitatet kritike dhe ekosistemet);
- Tendencat mjedisore dhe biologjike përfshirë, humbjet e habitateve, llojet invasive, mbishfrytëzimin, ngarkesën me substancë trofikuese dhe ndotëse, si dhe çështjet e përshtatshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- Faktorët klimatike dhe ndryshimet klimatike (p.sh shkarkimet e gazeve serrë nga përdorimi i tokës, ndryshimet e përdorimit të tokës, & pyjet, sektorët e popullsisë më të prekura nga ndryshimet klimatike);
- Trashëgimia kulturore, përfshirë atë të prekshme dhe atë të paprekshme si dhe zonat arkeologjike;
- Gjeomorfologjinë dhe gjeologjinë;
- Shëndetin dhe sigurinë (publike dhe të punëtorëve) si dhe infrastrukturën e kujdesit shëndetësor;
- Toka (përdorimet e mëparshme dhe aktuale, çështjet ligjore të sigurimit të tokës);
- Aspektet pamore dhe të peisazhit;
- Asetet materiale;
- Gjendja socio-ekonomike dhe jetesa e popullatës si dhe shërbimet e ekosistemit;
- Toka dhe nëntoka;
- Praktikrat e përfshirjes së palëve të interesit;
- Grupet e cënuara;
- Ujërat (infrastrukturë, aksesit, sasia dhe cilësia, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore);
- Infrastruktura e transportit (publike dhe e zonës së projektit); dhe
- Siguria dhe shëndeti publik dhe i punëtorëve.

Pritet të kryhen studime të thelluara, përfaqësuese të kushteve sezonale, për biodiversitetin, veçanërisht për popullatat rezidente dhe migruese të shpendëve dhe lakuriqëve, në përputhje me udhëzuesit metodologjikë si në vijim:

- Trashëgimia natyrore skoceze: “Shënime udhëzuese – metodat e monitorimit të popullatave të hpendëve në fermat eolike në tokë”.
- Trashëgimia natyrore skoceze: “Lakuriqët dhe turbinat me erë në tokë – vërtetim, vlerësim dhe zbulim”.
- Eurolakuriqët: “Udhëzues për marrjen në konsideratë të lakuriqëve në projektet e fermave eolike”

3.6 Konsultimi i Palëve të Interesit

Si pjesë e VNMS do të përshihen dhe detajet e programit të angazhimit të palëve të interesit si dhe rezultatet përkatëse të angazhimit, duke përfshirë:

- Analizën e grupeve kyç të interesit potencialisht të ndikuara nga Projekti si dhe palëve të tjera të interesit;
- Detaje të aktiviteteve të angazhimeve konkrete të realizuara me këto grupe të interesit përgjatë studimit përfshirë dhe të dhëna për pjesëmarrjen në këto aktivitete;
- Detaje dhe analiza për shqetësimet specifike, pyetjet dhe mundësitë për përmirësim të Projektit të ngritura nga palët përgjatë procesit të angazhimit të tyre; dhe
- Detaje për masat e marra (zmbardhje) si pasojë e konsultimit me palët e interesit sa i takon ndikimeve dhe masave zbuluese të Projektit.

3.7 Vlerësimi i ndikimeve

Ofertuesi i para-kualifikuar do të vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale dhe rreziqet e projektit përgjatë jetës së tij (para ndërtimit, ndërtimit, operimit, çmontimit/mbylljes, rehabilitimit) si dhe mundësitë që mund të ofrojë projekti, përfshirë por jo duke u kufizuar në: zhvillim të infrastrukturës si dhe përfitime ekonomike direkte, indirekte dhe të induktuara. Në objektin e vlerësimit të ndikimit do të përfshihet çdo infrastrukturë e lidhur me të.

Vlerësimi M & S do të përfshijë një analizë të ndikimeve të mundshme të projektit të propozuar dhe infrastrukturës që lidhet me të në mjedisin fizik, biologjik dhe socio-ekonomik, për të siguruar një identifikim dhe karakterizim të detajuar të ndikimeve të mundshme negative dhe pozitive M & S. Kjo do të përfshijë një identifikim të ndikimeve që mund të përjetohen në mënyrë jo të njëjtë nga grupet e cënueshëm. Vlerësimi do të përfshijë ndikimet M & S (përpara zbatimit të masave zbuluese) dhe ndikimet mbetëse. Sipas nevojës duhet të përgatiten harta për karakterizimin e duhur të ndikimeve, veçanërisht të atyre me një përhapje hapësirë të konsiderueshme.

Ndikimet në komponentët e ndryshëm të mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik do të vlerësohen duke përdorur teknikat e mira të VNMS-së (si p.sh. modelimin, vlerësimin e rrezikut, gjykimin profesional etj.) dhe përmes zbatimit të qëndrueshëm dhe transparent të një metodologjie vlerësimi të përcaktuar nga Konsulenti, e cila duhet të konsiderojë, nëse është e aplikueshme, ndër të tjera:

- Natyrën e ndikimit (pozitiv ose negativ);
- Lloji i ndikimit (direkt ose indirekt);
- Madhësinë e ndikimit;

- Mundësinë e shfaqjes së ndikimit;
- Kohëzgjatjen dhe shtrirjen hapsinore të ndikimit;
- Mundësinë e kthimit të ndikimit;
- Ndjeshmërinë, rëndësinë dhe cënueshmërinë e burimit ose receptorit;
- Limitet sasiore të përcaktuara (p.sh. normat limit të shkarkimeve dhe standartet e cilësisë së ajrit), etj.

Konsulenti duhet të paraqesë në raportin VNMS një vlerësim të rëndësisë së çdo ndikimi mbetës (pa dhe me zbatimin e masave zbutëse).

Gjithashtu studimi i ndikimit do të identifikojë mundësitë e përmirësimeve të mundshme dhe përcaktojë masat e realizueshme teknikisht dhe financiarisht për shmangien, ose kur shmangia nuk është e mundur, minimizimin, zbutjen ose kompensimin e ndikimeve negative (sipas hierarkisë së zbutjes). Gjithashtu do të identifikohen masat për rritjen e përfitimeve nga projekti.

Kur gjatë procesit të vlerësimit, individë ose grupe të prekur janë identifikuar si të cënueshëm ose në disavantazh, studimi do të përfshijë masa të diferencuara në mënyrë që ndikimet negative të mos shfaqen në mënyrë disproporcionale mbi ta dhe ata të kenë përparësi në mundësitë për të përfituar nga projekti.

Së fundi, vlerësimi i ndikimit do të paraqesë ndikimet mbetëse që rrjedhin nga zbatimi i masave zbutëse dhe përmirësuese.

Teknika të veçanta të analizës së ndikimeve pritet të përdoren në rastet në vijim:

- Do të nevojitet të kryhet një studim për pasqyrimin e dritës së diellit nga fletët e turbinës nëse studimi (VNMS) do të evidentojë një efekt të mundshëm në rezidentët lokalë në zonën e ndikimit të projektit. Kriteret që duhen përdorur janë ato që përfshihen në Udhëzuesit e Grupit të BB për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë për Energjinë e erës (2015).
- Do të nevojitet të përgatitet vlerësimi i rrezikut të përplasjes së shpendëve në rast se studimet e gjendjes së mjedisit do të evidentojnë praninë e një numri të konsiderueshëm ose lloje të kërcënuar shpendësh rrëmbenjës ose që ndjekin rrymat ajrore. Metodologjia e rekomanduar është “Fermat eolike dhe shpendët: Përlllogaritja e rrezikut teorik të përplasjes duke supozuar se nuk ka veprime shmangëse”. (SNH 2000)
- Do të nevojitet të përgatitet studimi i duhur për projekte që mund të kenë ndikim në Natura 2000 ose zonat kandidate të Rrjetit Emerald. Ky vlerësim duhet të kryhet në përputhje me kushtet e Nenit 6(3) dhe (4) të Direktivës së Habitaveve 92/43/EEC, dhe udhëzuesit metodologjik përkatës. Metodologjia e rekomanduar është “Udhëzues metodologjik për kushtet e Nenit 6(3) dhe (4) të Direktivës së Habitaveve 92/43/EEC”. Metodologjia e vlerësimit duhet të jetë në përputhje me metodologjinë e përgjithshme të VNMS-së të përshkruar në këtë dokument.

3.8 Menaxhimi i ndikimeve dhe çështjeve

Një përmbledhje e masave të mundshme me kosto efektive për shmangien, minimizimin, zbutjen ose kompensimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale në nivele të pranueshme dhe adresimi i çështjeve të tjera mjedisore dhe sociale. Përveç kësaj, një përshkrim i çdo mase që do të përmirësonte aspektet mjedisore dhe sociale brenda zonës së ndikuar nga projekti dhe operacionet ekzistuese ose karakterizimin e natyrës së ndonjë ndikimi të mbetur mjedisor ose social ose çështje që nuk janë adresuar. Një përshkrim i dispozitave financiare për rreziqet e mundshme (për shembull pagesa për pasuritë e paluajtshme dhe siguracion që të mbulojë ngjarje të tilla si braktisja, çmontimi apo rigjenerimi i terrenit, rrjedhjeve të vajrave dhe emergjencave të tjera). Sipas rastit duhen konsideruar fazat e projektit si në vijim:

- Faza para ndërtimit dhe e ndërtimit
- Operimi dhe mirëmbajtja
- Mbyllja dhe nxjerrja jashtë funksionimi
- Ndikimet mjedisore dhe sociale mbetëse.

3.9 Monitorimi dhe Mbikqyrja

Përshkrimin sesi ndikimet mjedisore dhe sociale dhe çështjet e duhura do të monitorohen dhe menaxhohen në praktikë, përfshirë dhe një sqarim sesi do të mbikqyret Projekti nga huadhënësit dhe agjencitë qeveritare. Vlerësimet duhet të japin dhe shpenzimet kapitale dhe ato operacionale si dhe kur është e mundur kostot e mirëmbajtjes. Sipas rastit duhen konsideruar fazat e projektit si në vijim:

- Faza para ndërtimit dhe e ndërtimit
- Operimi dhe mirëmbajtja
- Mbyllja dhe nxjerrja jashtë funksionimi
- Ndikimet mjedisore dhe sociale mbetëse.

3.10 Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social

Përshkrimi në Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social i masave për shmangien, minimizimin, zbutjen, kompensimin dhe monitorimin duke synuar përmirësimin e Projektit dhe shmangien dhe reduktimin e ndikimeve M&S. PMMS do të sigurojë që të gjitha fazat e Projektit të jenë të strukturuar në, për të përmbushur kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme dhe ato të PR, duke përfshirë:

- Një përshkrim të detajuar të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social, përfshirë politikat operacionale, planet e menaxhimit, sistemet e menaxhimit, programet, procedurat, praktikrat dhe investimet kapitale që duhet të zhvillohen dhe sigurohen si pjesë e strategjisë së përgjithshme për zbutjen e ndikimit;
- Burimet e nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të PMMS duke përcaktuar dhe rolet dhe përgjegjësitë për veprimet/masat zbutëse të përfshira në PMMS dhe azhornimet e mëtejshme të tij.
- Menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe përgjegjësitë e palëve të treta përfshirë dhe përgjegjësinë e Kontraktorëve për të hartuar Planin të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (specifike për zonën) të cilët duhet të miratohen nga Kompania;
- Nevojat për trajnime për forcimin e kapaciteteve për të siguruar që personeli i ngarkuar me zbatimin e PMMS ka formimin dhe kapacitetet e duhura për të zbatuar funksionet përkatëse në mënyrë eficiente;
- Indikatorë të performances për ndikimet e rëndësishme mjedisore dhe sociale përfshirë dhe elementet të tjerë të lidhura me Huadhënësit;
- Një plan monitorimi me synim që të gjurmohet veprimet e masat e përfshira në PMMS përfshirë ndonjë kërkesë monitorimi nga Rregullatori si dhe kërkesat për raportimin;
- Procedura në rast emergjencash dhe plane menaxhimi për të adresuar ndonjë zjarr apo shpërthim si dhe kapjen e kontrollin e ndotjes ndaj incideteve të mundshme (p.sh plane të reagimit ndaj emergjencave, masa për shuarjen e zjarrit dhe sisteme sinjalizimi dhe komunikimi)

- Një procedurë për menaxhimin e ndryshimit. Niveli i detajeve dhe kompleksiteti i PMMS do të reflektojë ndikimet e Projektit dhe çështje të adresimit të rrezikut si dhe ndikimet dhe oportunitetet specifike të Projektit. PMMS duhet të përcaktojë dhe rezultatet e synuara dhe të matshme dhe sipas mundësisë me elemente të tillë si objektiva të synuara dhe indikatorë të performancës që mund të gjurmohen gjatë kohës së zbatimit të Projektit.

Pritet që PMMS të përfshijë të paktën planet e menaxhimit të listuara më poshtë:

- Planin e veprimit për zhvendosjet dhe përvetësimin e tokës;
- Planin e Menaxhimit të Kontraktorit;
- Planin e Sigurisë dhe Shëndetit ndaj Komunitetit;
- Planin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë;
- Planin e Menaxhimit të Trafikut;
- Planin e menaxhimit të biodiversitetit.

3.11 Shtojcat

- Emrat e personave përgjegjës për hartimin e Vlerësimit Mjedisor dhe Social;
- Referenca të burimeve të informacionit;
- Regjistrimet e takimeve publike dhe konsultimeve të zhvilluara;
- Të dhëna teknike mbështetëse;
- Studimin për pasqyrimin e rrezeve të diellit;
- Raportin e përplasjes së shpendëve;
- Raportin e vlerësimit të duhur.

SHTOJCA 15

WIND SITING STUDY

Një vlerësim paraprak për çështjet e zonave të mbrojtura dhe të kriterit të qëndrueshmërisë në zgjedhjen e vendit për llogari të Autoritetit Kontraktues nga Ekipi i Konsulentëve.

Ky dokument ka për qëllim që të japë vetëm udhëzime dhe të mbështesë Ofertuesit dhe Ofertuesit e Kualifikuar për zgjedhjen e vendit në fazën e KPP. Ky dokument nuk do të interpretohet se do të përjashtojë nga përgjegjësia dhe detyrimi ligjor Ofertuesin (t) për zgjedhjen e Vendit të Propozuar.